



**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**FAKULTETI JURIDIK**

**STUDIME TË CIKLIT TË DYTË-PROGRAMI**  
**“E DREJTA CIVILE”**

**PUNIM MASTERI**

**TEMA:**

***“Bashkësia jashtëmartesore dhe fëmija jashtëmartesor sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë dhe praktikës së Gjykatës Themelore në Gostivar”***

**Mentori :**  
**Prof.Dr.Emine Zendeli**

**Kandidati :**  
**Pendije Shabani**

**Tetovë, 2019**

<b>HYRJE</b> .....	4
--------------------	---

## **KAPITULLI I**

### **RREGULLIMI JURIDIK I BASHKËSISË JASHTËMARTESORE**

1. Kuptimi i bashkësisë jashtëmatesore-definicioni.....	7
2. Bashkësia martesore dhe martesë	
3. Themelimi i bashkësisë jashtëmatesore.....	7
4. Neni 13 i LF-së të Republikës së Maqedonisë me komente.....	8
5. Njohja (notariteti).....	12
6. Monogamia.....	12
7. Llojet e bashkësisë jashtëmatesore.....	12
8. Ngjajshmëritë dhe dallimet e bashkësisë jashtëmatesore me martesën.....	13
9. Pushimi i bashkësisë jashtëmatesore.....	14
10. Pasojat e pushimit të bashkësisë jashtëmatesore.....	14

## **KAPITULLI II**

### **MARRËDHËNIET MES PRINDËRVE DHE FËMIJËVE**

1. Elementet themelore.....	15
2. Subjektet e së drejtës prindërore.....	16
3. Rëndësia e amësisë dhe e atësisë së fëmijës.....	19
4. Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesë.....	21
5. Përcaktimi (vendosja) i Vërtetimi i amësisë dhe i atësisë së fëmijës së lindur jashtë martese.....	23
6. Kundërshtimi i amësisë.....	25
7. Kundërshtimi i atësisë.....	26
8. Procedura për kundërshtimin e atësisë.....	27
9. Pasojat e kundërshtimit të atësisë.....	29

### **KAPITULLI III**

#### **POZITA JURIDIKE E FËMIJËVE JASHTËMARTESORË NË SISTEMIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

1. Nocioni i fëmijëve jashtëmartesorë.....	30
2. Vërtetimi i amësisë me vendim të gjykatës.....	32
3. Vërtetimi i atësisë me vendim të gjykatës.....	33
4. Kuptimi i të drejtës prindërore.....	35
5. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve.....	36
6. Marrëdhëniet pasurore juridike të prindërve dhe fëmijëve.....	39
7. Të drejtat dhe detyrat e fëmijëve.....	43

### **KAPITULLI IV**

#### **SHQYRTIME KRAHASUESE TË MATERIES SIPAS LEGJISLACIONIT VENDAS DHE LEGJISLACIONEVE TË HUAJA**

1. Bashkëshorti jashtëmartesorë sipas Legjislacioneve të huaja.....	44
2. Legjislacionet e vendeve të huaja në mbrojtjen ligjore të bashkësisë jashtëmartesore.....	46
3. Bashkësia jashtëmartesore mes gruas dhe burrit në Ligjin për familje.....	49
4. Konventa për të drejtat e fëmijës.....	55
5. Aktet regionale të cilat rregullojnë marrëdhëniet në familje.....	56
6. Konventa Evropiane mbi statusin ligjor të fëmijëve ë lindur jashtë martese.....	56
7. Shembuj nga praktika gjyqësore.....	59
8. Regjistrimi i bashkësisë jashtëmartesore te noteri.....	62

<b>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>64</b>
--	-----------

<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>66</b>
--------------------------	-----------

## HYRJE

Bashkëjetesa, ndërsa është një institut i ri juridik, nga pikëpamja sociale, ajo është po aq e lashtë sa edhe martesë e familja. Edhe ndjeshmëria ligjore ndaj këtij institucioni kanë qenë sa e dukshme, po aq edhe e ndryshme në kohë të ndryshme.

E drejta zakonore shqiptare dënonte bashkësinë jashtëmartesore, në ndërkohë që njihte katër lloje martesash: martesën me kurorë, martesën mbi kurorë, martesën me provë dhe martesën me grabitje. Martesat mbi kurorë ose me provë ishin llojet e martesave që ndaloheshin e dënoheshin sipas ligjit të sipërcituar. Sipas këtij ligji, ata që bashkoheshin si burrë e si grua sipas zakoneve të vendit për martesë ose që gjendeshin pa e celebruar martesën sipas ligjit, ndëshkoheshin.

Në kushtet bashkëkohore të jetesës shtrohet pyetja se: a konkurrohet martesë nga bashkëjetesa? A është në rrezik martesë?

Bashkëjetesa haptas ishte një dukuri sporadike aty nga fillimi i viteve '90 ajo hyri në formatin e sjelljeve liberale. Themi kështu, sepse ndryshimet e mëdha shoqërore dhe transicioni i bëri njerëzit gradualisht më “liberal”. Kjo ndodhi me të gjithë shoqërinë. Dhe ndodhi që liberalizimi i lirive vetjake (personale) ishte ngacmimi që evidentoi këtë dukuri të fshehur. Pati një reagim kryesisht të brezit të ri, për të flakur tej moralin tradicional dhe zakonet, për të bërë ndryshe.

Ritmi i shpejtë i ndryshimeve shoqërore në shumicën e vendeve të Europës në këta njëzet vitet e fundit është karakterizuar përgjithësisht nga ulja e numrit të martesave dhe rritja e numrit të shkurorëzimeve. Prirjet e reja në sjelljet bashkëshortore tregojnë se një numër i madh të rinjsh “e shijnë” martesën ose ndoshta edhe nuk martohen fare. Martesë ligjore, e konsideruar “dikur” si e vetmja formë e ligjshme e partneritetit (marrëdhënieve) u ka lënë vendin rregullave të bashkëjetesës së çiftit ( more uxorio ). Martesat formale po e humbasin kuptimin e mëparshëm, veçanërisht në vendet e zhvilluara të Europës.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup>Arta Mandro, ....

Sot, instituti i familjes dhe alternativa e përmasat e tij janë në procesin e një ndryshimi a transformimi të shpejtë. Familje kemi edhe atëherë kur çifti bashkëjeton jo në martesë. Prandaj numri i bashkësive jashtëmartesore është githnjë e në rritje, ndërsa martesë si institucion dalëngadalë po humb rëndësinë e vet.

Rregullohet juridikisht ose, më mirë të themi pranohet ligjërisht për herë të parë dhe jepet për herë të parë kuptimi i bashkëjetesës në nenin 13 i Ligjit për familjetë Republikës së Maqedonisë (1992) Definicioni (neni 163 nga Kodi i ri i Familjes 2003): “Bashkëjetesa” është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.”

### **1. Bashkësisë jashtëmartesore dhe martesës**

Bashkësia jashtëmartesore dhe martesë janë dy institute të vecanta me identitet të vecante, por, që kanë edhe shumë pika të përbashkëta. Ngjajshmëri, ose anë të përbashkëta, midis martesës dhe bashkëjetesës janë:

- Ngjajshmëria kryesore ndërmjet bashkësisë jashtëmartesore dhe martesës është në përmbajtjen e përbashkët. Sic, është bashkësia jetësore e një burri dhe një gruaje; tërësia e marrëdhënieve të tyre emocionale, intelektuale, ekonomike, sociale etj.
- Parimi i heteroseksualitetit dhe monogamisë.
- Pëlqimi i lirë.
- Jetesa e përbashkët e burrit dhe e gruas, çka do të thotë që ata kanë një vendbanim, një mjedis, ku konsumojnë jetën e përbashkët dhe ku ndajnë të mirat dhe shqetësimet.
- Karakteri i stabilizuar dhe i vazhdueshëm i jetës së bashku, çka do të thotë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie të qëndrueshme, jo rastësore që në këtë plan, ngjan me bashkëjetesën në martesë.
- Nëse gjatë bashkëjetesës lindin fëmijë, çështja më e rëndësishme është se fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të njëjtat të drejta me fëmijët e lindur nga martesë.<sup>2</sup>

Sa ndryshon bashkëjetesa nga martesë? Edhe shumë, edhe pak. Kjo është një përgjigje oportuniste, por edhe realiste.

---

<sup>2</sup> ....

- Që të quhesh i martuar duhet të realizosh lidhjen e martesës sipas kërkesave të ligjit. Të martuar janë burri dhe gruaja që kanë lidhur martesë publikisht para organit kompetent shtetëror, që është nëpunësi i gjendjes civile. Bashkëjetesa nuk ka lidhje me një formë të tillë. Edhe sikur gjithë jetën dy persona të jetojnë së bashku, statusi i tyre nuk ndryshon. Ata nuk do të quhen kurrë të martuar, nëse nuk realizojnë martesën e njohur ligjrisht.
- Lidhja e martesës konform ligjit jep një status të veçantë. Për shkak të martesës quhesh i/e martuar dhe, nëse bashkëshorti vdes, i/e ve ose, nëse martesë zgjidhet i/e divorcuar. Nuk ka asnjë ndryshim në statusin e personit për shkak të bashkëjetesës.
- Ndërsa një martesë e lidhur në mosplotësim të kushteve dhe ndalesave martesore është e pavlefshme juridikisht, për bashkëjetesën flasin për kushte dhe ndalesa, aq sa ligji na i mundëson këto. Edhe nëse ato nuk janë respektuar, kjo nuk do të thotë që bashkëjetuesit mund të kërkojnë pavlefshmërinë e bashkëjetesës në rrugë gjyqësore.
- Bashkëshortët e martuar ligjrisht qëndrojnë në këtë gjendje deri sa njëri prej partnerëve vdes ose deri sa martesë mbaron për shkak të zgjidhjes së martesës (neni 123 KF), LF i Maqedonise<sup>3</sup> ose sepse është e pavlefshme. Personat quhen të martuar edhe kur ata nuk jetojnë bashkë. Kjo sepse, që t'i japësh fund martesës, duke e zgjidhur atë, detyrimisht duhet t'i drejtohesh gjykatës.

Në përcaktimin e një fëmije si të lindur jashtë martesë kanë rëndësi një sërë rrethanash, por në mënyrë të veçantë statusi civil i nënës në kohën kur e ka konceptuar fëmijën dhe veçanërisht kur e ka lindur atë. Në një kuptim të drejtëpërdrejtë mund të themi se do të konsiderohet fëmijë i lindur jashtë martesë ai fëmijë që është lindur nga një grua e cila në momentin e konceptimit dhe të lindjes së fëmijës nuk rezulton e martuar në aktet e saj të gjendjes civile. Por me këtë shpjegim, ligjrisht nuk do të ishim të saktë, sepse, siç e dimë, edhe 300 ditë pas zgjidhjes së martesës ose shpalljes së saj si e pavlefshme, fëmija do të konsiderohet se ka për atë ish burrin e nënës, pra konsiderohet i lindur nga martesë e nënës.<sup>4</sup> Gjithashtu, dimë se edhe në raste kur nëna ka qenë beqare në momentin e konceptimit të fëmijës, por rezulton e martuar kur e lind atë, ai fëmijë, gjithashtu, do të konsiderohet si bir i burrit të nënës, pra, i lindur nga martesë gjithashtu.

<sup>3</sup>...LF i Maqedonise dhe KF i shqiperise

<sup>4</sup>Neni x LF Maqedoni

Gjithashtu, do të konsiderohet fëmijë i lindur jashtë martesë edhe ai fëmijë që, ndonëse është lindur prej një gruaje të martuar ligjërisht, atësia e prezumuar e burrit të ligjshëm të nënës është çnjohur me vendim gjyqësor të formës së prerë, mbi bazën e kundërshtimit të tij.

Së fundi, mendoj se mund të konsiderohet si fëmijë të lindur jashtë martesë edhe ata fëmijë që, në aktin e lindjes dhe në regjistrin themeltar të shtetasve, janë regjistruar me prindër të panjohur.

## **KAPITULLI I**

### **RREGULLIMI JURIDIK I BASHKËSISË JASHTËMARTESORE**

#### **1. Kuptimi dhe definicioni i bashkësisë jashtëmartesore**

Bashkësia jashtëmartesore përfaqëson "hijen" besnike që e përcjell martesën nga shfaqja e saj tek njerëzimi deri më sot. Në shoqëritë moderne si rezultat i faktorëve të shumtë, bashkësia jashtëmartesore bëhet një formë gjithnjë e më e përfaqësuar e bashkësisë në jetë që paraqet një kërcënim serioz dhe një alternativë ndaj martesës.

Bashkësia jashtëmartesore është bashkësi faktike midis burrit dhe gruas.<sup>1</sup> Qëllimi themelor i formimit të saj është bashkësiat jetësore e cila duhet të ketë zgatur një periudhë të konsiderueshme kohore dhe të jetë e vazhdueshme.

Për të shkaktuar efekte juridike, bashkësia jashtëmartesore kërkohet të ketë qenë e njohur së ekzistuari nga mjedisi i caktuar. Sipas nenit 13 LF Te Maqedonisë.....4 të LFK-së, si kusht për ekzistimin e bashkësisë jashtëmartesore, është që kjo bashkësi duhet të ketë ekzistuar mbi një vit.

Bashkësia jashtëmartesore përkufizohet si bashkësi e jetës së vazhdueshme, e themeluar me vullnetin e shprehur të një burri dhe një gruaje, të cilët kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë

bashkërisht për një kohë të gjatë në bashkësi jashtëmartesore, ndërsa bashkësia është e njohur edhe nga mjedisi ku ajo është themeluar. Pra, ajo është bashkësi monogamie dhe mbaron me pushimin e qëllimit të jetesës së përbashkët.

## 2. Themelimi i bashkësisë jashtëmartesore

Bashkësia jashtëmartesore themelohet me shprehjen e vullnetit në mënyrë joformale të një burri dhe një gruaje për jetesë të përbashkët. Së këndejmi, elementi themelor konstituiv i bashkësisë jashtëmartesore del se është jetesa e përbashkët e burrit dhe gruas. Më kryesore këtu është se nuk duhet të mungojë qëllimi i jetesës së përbashkët. Kjo do të thotë se nuk është e domosdoshme gjithmonë që bashkëshortët jashtëmartesorë të jetojnë në një banesë të përbashkët.

Kushtet e tjera që duhet për t'i plotësuar për themelimin e bashkësisë jashtëmartesore janë: lidhja emocionale, ndihma materiale dhe e ndërsjellë e bashkëshortëve jashtëmartesorë. Nga kjo nënkuptohet se burri dhe gruaja në bashkësi jashtëmartesore bëjnë jetesë të njëjtë sikurse në bashkësi martesore.

---

<sup>1</sup>Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar, citat, fq. 9

## 3. Neni 13 i LF-së të Republikës së Maqedonisë me komente Rregullimi ligjor i bashkësisë jashtëmartesore në Republikës së Maqedonisë

Sipas dispozitës nga paragrafi 2 neni 40 i Kushtetutës së RM-së, marrëdhëniet juridike në kurorë, familje dhe bashkësi jashtëmartesore rregullohen me ligj. Pra, baza ligjore e rregullimit të bashkësisë jashtëmartesore gjendet në Kushtetutën e RM-së, ashtu që dispozitat nga neni 13 (nacion), 193 (mbështetje reciproke) dhe 218 (pasuri e përbashkët), që kanë të bëjnë me bashkësinë jashtëmartesore bazohen në këtë dispozitë Kushtetuese.<sup>5</sup>

Në dispozitën e nenit 13 të Ligjit për familje të RM thuhet se: bashkësia e jetës së burrit dhe gruas nuk është themeluar në përputhje me dispozitat e këtij ligji (bashkësi jashtëmartesore) dhe e cila ka zgjatur së paku një vit, dhe është barazuar me bashkësinë martesore në pikëpamje të të drejtës për mbështetje dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjatjes së asaj bashkësie.

Dallimi mes bashkësisë martesore dhe jashtëmartesore është lidhja zyrtare e kurorës dhe ndërprerjes së saj në rastet e parapara me ligj, para organit kompetent. Bashkësia jashtëmartesore krijohet konform vullnetit të partnerëve jashtëmartesorë, në mënyrë të shprehur ose me heshtje dhe kështu përfundon. Çështja më e madhe juridike të bashkësia jashtëmartesore rezulton nga mangësia e formalitetit që do ta shënonte fillimin dhe fundin e saj, e cila gjë është me rëndësi për fitimin dhe humbjen e disa të drejtave dhe detyrimeve .

---

<sup>5</sup> Neni 40, paragr. 2. Kushtetuta e .....



Elemente konstituive të bashkësisë jashtëmartesore janë dallimi mes gjinive, monogamia, bashkësia e jetës, stabiliteti dhe kohëgjatësia. Bashkësia jashtëmartesore paraqet bashkësi të jetës mes burrit dhe gruas. Megjithatë në vendet e Evropës Perëndimore ekzistojnë përpjekje që të pranohet e drejta e bashkësisë në jetë të dy personave me gjinë të njëjtë.

Përmes bashkësisë jashtëmartesore perceptohet vullneti dhe qëllimi për realizimin e bashkësisë në jetë mes burrit dhe gruas që nënkupton bashkësi në jetë, bashkëjetesë. Që të njihet bashkësia jashtëmartesore duhet të paraqiten dhe manifestime të jashtme. Kjo e përjashton ekzistimin e marrëveshjes mes partnerëve jashtëmartesorë për udhëheqjen e amvisërive të ndara dhe vendeve të ndryshme të jetesës gjë që mundëson që të arrihet bashkësia martesore. Monogamia e bashkësisë jashtëmartesore tregon në atë që njëkohësisht nuk mund të ekzistojnë më tepër bashkësi nga ana e një personi.

Nocioni bashkësi jashtëmartesore nënkupton se ajo zgjat gjatë që sugjeron dhe në stabilitetin e saj. Në bashkësi jashtëmartesore burri dhe gruaja jetojnë sikur të jenë në kurorë. Perceptimi i jashtëm i saj nuk dallon nga perceptimi i rëndomtë i bashkësisë martesore.

Nevoja për rregullimin e bashkësisë jashtëmartesore rezulton nga çështjet lidhur me ndërprerjen e saj, sidomos ajo ka zgjatur gjatë dhe derisa partnerët jashtëmartesor kanë pasur të ardhura të përbashkëta dhe shpenzime dhe derisa kanë fëmijë të përbashkët. Nocioni ligjor i bashkësisë jashtëmartesore përfshinë dy elemente dhe atë : bashkësia jashtëmartesore paraqet bashkësi afatgjate jete mes burrit dhe gruas dhe atë doemos të jetë e lirë, pikërisht mes partnerëve jashtëmartesorë nuk duhet të ekzistojnë pengesa martesore. Derisa bashkësia jashtëmartesore i përmban këto dy elemente në atë rast do të prodhojë veprime që parashihen në ligj.

Partnerët jashtëmartesor kanë të drejta dhe detyrime si gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë jashtëmartesore ashtu dhe pas ndërprerjes së saj. Ata të drejta dhe detyrime janë me karakter personal dhe pasurorë.

Analizë më të detajuar të dispozitës nga neni 13 nga LF, në raport të nocionit, përmbajtjes dhe thelbit të bashkësisë jashtëmartesore tregon në atë se :

- ajo është bashkësi jete e burrit dhe gruas, që d.m.th. në atë pikëpamje ajo i përfshinë të gjitha nevojat komplekse të ndërthurura të secilit nga partnerët jashtëmartesorë, siç janë ata psikike, seksuale, ekonomike, eventuale, rritja e fëmijëve etj., që është e përafërt me kurorën. Derisa në atë ka dhe fëmijë dhe ajo gjendet nën mbrojtjen e posaçme të shtetit, që i ndahet familjes,
- bashkësia jashtëmartesore, në raport të themelimit të saj si dhe marrëdhënies mes partnerëve jashtëmartesorë, përveç se në pikëpamje të së drejtës së mbështjes reciproke dhe pasurisë së fituar gjatë asaj bashkësie, nuk është e rregulluar me ligj. D.m.th. se ajo ekziston derisa është themeluar faktikisht, që shprehet përmes banimit të përbashkët, familjes së përbashkët, bashkësisë ekonomike, ndihmesës reciproke dhe plotësimit të nevojave tjera që i karakterizojnë dhe marrëdhëniet e tyre,

- nuk është thelbësore a është krijuar ajo dhe përsëri ekzistimit të pengesave në bashkësi, adoloshencë (neni 16), kurorë ekzistuese të njërit ose të të dy partnerëve jashtëmartesorë (neni 17), huti (neni 17), afërsi gjaku (neni 20), miqësi (neni 21),
- nuk mund të llogaritet që ekziston familja jashtëmartesore derisa ajo nuk është vendosur me forcë ndaj njërit ose të dy partnerëve jashtëmartesorë (neni 15, 19), ose me person që nuk mund ta kuptojë rëndësinë e bashkësisë së tillë (neni 18), pasi që atëherë nuk mund të bëhet fjalë për krijim bashkësie, por për shfrytëzim të gjendjes së njërit ose tjetrit partner jashtëmartesor, që mund të tërheqë si dënim si dhe pasoja pronësore juridike, si dje jo të atyre që janë paraparë për bashkësinë jashtëmartesore,
- nuk mund të llogaritet se ekziston bashkësia jashtëmartesore derisa është prishur rregulli për monogami, në kuptim faktik. Kështu, për burrin që jeton në bashkësi me bashkëshorten, kurse përveç saj mban dhe marrëdhënie jashtëmartesore me grua tjetër në cilën shtëpi shpesh qëndron, flenë, sa që ekziston dhe diç që i ngjan bashkësisë familjare, me kontribut të përbashkët në shpenzimet për të, nuk mund të vërtetohet se ka dhe bashkësi jashtëmartesore me grua tjetër që nuk e ka bashkëshorte. Megjithatë, do të mund të jetonte në bashkësinë jashtëmartesore personi që formalisht është në kurorë me person tjetër me gjini tjetër, por faktikisht bashkësi martesore nuk ekziston, kurse ai person jeton në bashkësi jashtëmartesore me person tjetër me gjini të ndryshme,
- nuk do të mund të llogaritet se ekziston bashkësi jashtëmartesore derisa bëhet fjalë për marrëdhënie të përkohshme, afatshkurte ose marrëdhënie jashtëmartesore kohë pas kohe, të cilat ndërprerje zgjasin dhe më tepër se një vit,
- nuk llogaritet bashkësi jashtëmartesore, me pasoja që rezultojnë nga neni 13, 193 dhe 287 nga LF-së, derisa bashkësia jashtëmartesore, me të gjitha atributet e saj, ka zgjatur së paku një vit. Gjatë kësaj, ngarkesa për vërtetimin e kohës së themelimit të bashkësisë jashtëmartesore, për atë që ajo nuk është ndërpre dhe për atë se ajo ka zgjatur së paku një vit, bie mbi personin që e pohon atë dhe prej ku rezultojnë të drejtat e caktuara (neni 205 dhe 290 nga Ligji për procedurë kontestimore – LPK).

Nga praktika gjyqësore shënojmë dhe atë se nuk ka veprim juridik marrëveshja e partnerëve jashtëmartesorë me të cilin kanë rënë dakord që pasuria e fituar në bashkësinë jashtëmartesore nuk do të llogaritet si pasuri e tyre e përbashkët.

Bashkësive jashtëmartesore u jepet mbrojtje në të drejtën familjare për herë të parë me Ligjin për familje, pasi që dispozitat me të cilat rregullohen marrëdhëniet familjare në RM, nuk përmbanin dispozita për bashkësinë familjare.

Sipas dispozitave të nenit 143 nga LF-ja, bashkësia jashtëmartesore, derisa i përmbush kushtet e parapara, është e barabartë me bashkësinë martesore, por vetë, në pikëpamje të

mbështetjes reciproke të partnerëve jashtëmartesorë (neni 193),<sup>6</sup> dhe pasurisë së fituar gjatë kohëzgjates së bashkësisë (neni 218). Praktika gjyqësore e zgjeron të drejtën e bashkësisë jashtëmartesore dhe të drejtës banesore që e ka pasur partneri tjetër jashtëmartesor në banesë në pronësi shoqërore (vendimi GJS në RM Gb nr.39/96 nga 2.10.1996 shpallur në Përm. V fr.10-a).

Sipas nenit 201 paragraf 4 nga Ligji për detyrime partneri jashtëmartesor ka të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial për sëmundje shpirtërore në rast të vdekjes ose invaliditet të rëndë të partnerit jashtëmartesor, derisa mes tyre ka akzistuar bashkësi permanente.

Sipas nenit 318 paragrafi 1 pika 4 nga Ligji për detyrime, sërish, parashkrimi nuk kalon mes partnerëve jashtëmartesorë, derisa zgjat bashkësia jashtëmartesore, e cila dispozitë ka të bëjë dhe me ndërprerjen e mbështetjes për të fituar ndonjë të drejtë sendore (neni 30 paragraf 3 nga LDLDS).

Nuk është paraparë trashëgimi të ndërsjellë e partnerëve jashtëmartesorë në bazë të ligjit – shiko dispozitat nga Ligji për trashëgimi.

Bashkësia jashtëmartesore ndërpritet: kur bashkëshortët jashtëmartesorë lidhin kurorë, kur partnerët do ta prishin bashkësinë jashtëmartesore, qoftë me pëlqim ose me lëshimin e bashkësisë nga njëri prej tyre, me vdekjen e njërit ose të dy partnerëve jashtëmartesorë.

Në literaturën më të re (shiko D-r Dejan Mickoviq: “Rregullimi juridik i bashkësisë jashtëmartesore” “Pravnik” nr. 195-196/2008) tregon në atë se në bashkësitë bashkëkohore bashkësia jashtëmartesore është formuar në një numër të madh familjesh, si në vendet Skandinave, ku numri i bashkësive jashtëmartesore është barazuar me numrin e kurorave.

Me rritjen e numrit të bashkësive jashtëmartesore ligjvënësit ballafaqohen me disa aktvendime të mundshme: t’i injorojnë, të ndërmarrin masa represive kundër bashkësive të tilla, ose ta pranojnë dhe rregullojnë këtë fenomen të ri, që është shprehje e vlerave të ndryshuara dhe normave morale në shoqërinë postmoderne. Mu për këtë, këtu kemi prezent të a.q. “integrim juridik” që percepton në pranimin dhe inkorporimin e sistemit juridik të fenomeneve që më parë nuk kanë qenë të rregulluara, siç është rasti me bashkësinë jashtëmartesore.

Më në fund, pasi që bëhet analizë në nenin 13 nga LF në të cilin nuk është rregulluar bashkësia jashtëmartesore, konkludohet se rregullimi i tashëm ligjor i bashkësisë jashtëmartesore në RM ka mangësi të caktuara. Propozohet që mundësisht ligjvënësi të mendojë për vendosjen e rregjimit të plotë, me të cilin do të rregulloheshin të gjitha këto çështje, ku partnerët jashtëmartesorë do të lidhnin marrëveshje të posaçme, në procedurë të thjeshtë dhe të shpejtë. Ata partnerë jashtëmartesorë, që nuk do të lidhnin asnjë marrëveshje,

---

6  
.....

me dëshirë që ta ruajnë lirinë e tyre (absolute), do të ballafaqoheshin me të gjitha pasojat që rezultojnë nga ajo liri. Ata më parë do të pranonin që jeta jashtëmartesore nuk do të ishte bazë për të fituar disa të drejta që janë të caktuara për kurorë.

Me këtë ligji nuk do ta vinte në pyetje lirinë e zgjedhjes së njerëzve vetë të vendosin për llojin e bashkësisë së tyre. Por në të kundërtën, ata do të kishin liri më të madhe të zgjedhin se në cilën bashkësi dëshirojnë të jetojnë dhe çfarë pasojash juridike janë të gatshëm t'i pranojnë. Ligji i tillë do të ishte më fleksibil dhe më adekuat në ndryshimet e shpejta në sferat e marrëdhënieve personale, ndryshime që praktikisht do të thotë lëshim në konceptin se kurora e vetme mund të jetë e pranueshme si formë e rregulluar ligjore e bashkësisë në jetë në shoqërinë bashkëkohore.

#### **4. Njohja ( notariteti )**

Në fakt, duhet të ekzistoj njohuria e rrethit për qenien e bashkësisë martesore në mjedisin në të cilin ajo themelohet dhe vazhdon të ekzistojë. Me këtë ajo dallohet patjetër nga lidhjet e fshehta të dashurisë apo partneriteti i rastit.<sup>2</sup>

Njohuria e rrethit për qenien e bashkësisë jashtëmartesore është e një shkalle të dukshme, kur transparenca e jetesës si burrë dhe si grua e bashkëshortëve jashtëmartesorë është e dukshme. Bashkëshortët nuk e fshehin, por dalin në mënyrë transparente dhe këto bashkësi në të shumtën e herëve përfundojnë në martesë.

#### **5. Monogamia**

Kushti themelor për themelimin e bashkësisë jashtëmartesore është vullneti i shprehur i burrit dhe i gruas për jetesë të përbashkët. Nga kjo rezulton se bashkësia jashtëmartesore, ashtu sikurse ajo martesore, është monogame.

Kjo do të thotë se në të njëjtën kohë asnjëri prej bashkëshortëve jashtëmartesorë nuk mund të jetë në më shumë se një bashkësi martesore.

#### **6. Llojet e bashkësisë jashtëmartesore**

Në literaturën juridike janë të njohura disa lloje të bashkësisë jashtëmartesore, si: bashkësia jashtëmartesore e çastit ose sporadike, e përkohshme, e përhershme dhe bashkësia jashtëmartesorejostabile.

Emëruesi i përbashkët i të gjitha llojeve të kësaj bashkësie është jetesa e përbashkët. Kjo do të thotë se model i bashkësisë jashtëmartesore është bashkësia martesore.

Deri vonë bashkësia jashtëmartesore nuk ka qenë e rregulluar me ligj sepse, sic ka thënë Napoleon Bonaparte: “bashkëshortët jashtëmartesor nuk i nënshtrohen ligjit, ligji për ta nuk interesohet”. Shumë të drejta të vendeve të ndryshme, të cilat ishin nën ndikimin e së drejtës franceze, bashkësinë jashtëmartesore nuk e rregulluan me norma ligjore. Ligji ynë përfamiljen pjesërisht e ka rregulluar bashkësinë jashtëmartesore, dhe atë në pjesën që ka të bëjë me detyrimin e ushqimit, pasurinë e përbashkët të bashkëshorteve jashtëmartesore si dhe barazimin e fëmijëve të lindur në bashkësi martesore me fëmijët e lindur në martesë, si rregullim juridik i bashkësisë jashtëmartesore.

---

<sup>2</sup>Dr Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: vepra e cituar, faqe 128  
Do ta dergosh tek bashkejetesa dhe martesja

## **7. Ngjajshmëritë dhe dallimet e bashkësisë jashtëmartesore me martesën**

Në doktrinën juridike, si ngjajshmëri kryesore e këtyre dy institucioneve të rëndësishme konsiderohet jetesa e përbashkët. Si martesën, ashtu edhe bashkësinë jashtëmartesore e themelojnë burri dhe gruaja, ku, si subjekte të tyre ata realizojnë një korpus të tërë marrëdhëniesh ekonomike, sociale, intelektuale, etj.

Sipas disa pikëpamjeve, komponenti i jetesës së përbashkët është shprehur shumë më i fuqishëm në bashkësinë jashtëmartesore sesa në atë martesore. Nëse jeta e përbashkët mungon, martesja mbetet vetëm formë në letër, ndërsa prej bashkësisë martesore nuk mbetet asgjë.<sup>3</sup>Ngjajshmëri tjetër mes këtyre dy institucioneve është fakti se të dy bashkësitë i themelojnë personat me seks të kundërta, gjë që nënkuptohet vetvetiu se ata kryejnë edhe marrëdhënie seksuale.

Ndërkaq, mund të thuhet se mes bashkësisë martesore dhe asaj jashtëmartesore ekzistojnë po ashtu dallime të theksuara. Dallimet më qenësore kanë të bëjnë me mënyrat e themelimit.

Martesa lidhet solemnisht përpara organit zyrtar, shtetëror në formën e përcaktuar shprehimisht me dispozita ligjore. Ajo mbaron, po ashtu, vetëm në formën e përcaktuar ligjore. Ndërsa te bashkësia jashtëmartesore puna qëndron ndryshe, ajo themelohet me pëlqimin e vullnetit të dy bashkëshortëve jashtëmartesorë, qoftë shprehimisht, qoftë heshtazi, kurse në të njëjtën mënyrë ajo mbaron së ekzistuari.<sup>4</sup>

---

<sup>3</sup>Dr Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: vepra e cituar, faqe 126

<sup>4</sup>Dr Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: vepra e cituar, faqe 127

## **8. Pushimi i bashkësisë jashtëmartesore**

Bashkësia jashtëmartesore mbaron në mënyrë natyrore me vdekjen e njërit apo të të dy bashkëshortëve jashtëmartesorë, ngase ekzistenca e kësaj bashkësie është ngushtë e lidhur me personat që e kanë themeluar.

Bashkësia jashtëmartesore mbaron edhe kur njëri apo që të dy bashkëshortët jashtëmartesorë deklarohen të zhdukur për të vdekur. Mund të thuhet se bashkësia jashtëmartesore mbaron edhe për të gjallë të bashkëshortëve jashtëmartesorë. Për të gjallë të bashkëshortëve jashtëmartesorë, bashkësia jashtëmartesore mbaron me marrëveshje të dyanshme të bashkëshortëve jashtëmartesorë.

Mbarimi i bashkësisë jashtëmartesore mund të bëhet edhe në mënyrë të njëanshme- në mirëbesim apo në keqbesim. Konsiderohet se kjo bashkësi ka mbaruar me shkëputjen e njëanshme në mirëbesim në qoftë se shkëputja ka ardhur si rezultat i veprimit të njëanshëm të

bashkëshortit jashtëmartesor, i cili është lënë në keqbesim, është rrahur, fyer etj. nga bashkëshorti tjetër jashtëmartesor. Fajësia nuk ekziston, për faktin se shkaqet e shkëputjes edhe pas vlerësimit veç e veç të secilit rast konkret dalin të justifikueshme.

Përkundrazi, konsiderohet se shkëputja është bërë në keqbesim kur bashkësia mbaron për shkaqe të paarsyeshme, ndërsa fajtor për shkëputjen e saj është bashkëshorti, i cili në mënyrë të njëanshme lë bashkëshortin tjetër jashtëmartesor.

## 9. Pasojat e mbarimit të bashkësisë jashtëmartesore

Pas mbarimit të bashkësisë jashtëmartesore, sidomos të asaj në keqbesim, mbetet një grumbull çështjesh të pa zgjidhura juridikisht. Ato janë kryesisht çështje të njëjta të cilat kërkojnë zgjidhje pas zgjidhjes së martesës.<sup>5</sup> Megjithatë, kur është fjala për bashkësinë jashtëmartesore, numri i këtyre çështjeve të pazgjedhura është dukshëm më i vogël krahasuar me bashkësinë martesore. Kryesisht, mbarimi i bashkësisë jashtëmartesore shkakton tri lloj pasojash: a) pasojat e natyrës personale pasurore (ushqimi i detyrueshëm), b) pasojat e natyrës pasurore (pjesëtimi i pasurisë së përbashkët) dhe c) pasojat për fëmijë. Pasojat për fëmijë kanë të bëjnë me përkujdesjen, ruajtjen dhe edukimin e tyre.

---

<sup>5</sup>Dr Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: vepra e cituar, faqe 131

## KAPITULLI II MARRËDHËNIET MES PRINDËRVE DHE FËMIJËVE

### 1. Tri elementet themelore

Marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve karakterizohen nga tri elemente themelore: a) natyror, b) shoqëror dhe c) juridik.

- a) **Elementi natyror.**- Që nga gjeneza e deri më sot marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve janë themeluar me lindje në mënyrë natyrore. Elementi natyror (biologjik) i këtyre marrëdhënieve sado që besnikërisht ndoqi këto marrëdhënie gjatë shekujve, në kushtet e vështira të luftës për ekzistencë dhe për pushtimin e natyrës, ai prapëseprapë nuk qe element i vetëm, por u shoqërua edhe me elemente të tjera, si ai shoqëror dhe ai juridik.
- b) **Elementi shoqëror.**- Marrëdhëniet prindërore karakterizohen edhe nga elementi shoqëror. Sepse, çdo shoqëri i ka rregulluar në mënyrën e vet marrëdhëniet e krijuara mes prindërve dhe fëmijëve, që me lindjen e fëmijës. Jashtë familjes, asnjë person nuk ka mundur të sigurojë ekzistencën dhe reproduksionin biologjik, qoftë ajo

patriarkale, apo e ndonjë lloji tjetër. Andaj, elementi shoqëror i karakterizon edhe marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve.

- c) **Elementi juridik.**- Marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve fitojnë karakter juridik me rregullimin e tyre me norma juridike.<sup>6</sup>

Parimet themelore mbi rregullimin e marrëdhënieve të prindërve dhe fëmijëve i përmbajnë kushtetutat e çdo vendi. Me nenin 5 të Kornizës Kushtetuese të Kosovës janë përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve të përkohshme vetëqeverisëse edhe në fushën e mbrojtjes së familjes, të gruas dhe të të miturve.

Ndërkaq, me Ligjin për familjen, të Kosovës, janë rregulluar në mënyrë të tërësishme të gjitha marrëdhëniet, të drejtat dhe detyrimet nga e drejta familjare. Në veçanti marrëdhëniet e prindërve dhe të fëmijëve.

Krahas me shkallën e rritjes, fëmijët e mitur e kanë përmirësuar pozitën e tyre në shoqëri dhe në familje, ndërsa fëmijët jashtëmartesorë, fatkeqësisht, për një kohë të gjatë kanë qenë të injoruar dhe të diskriminuar derisa kanë fituar statusin e barabartë me fëmijët martesorë.

Tani, jo vetëm që fëmijët janë barazuar në pikëpamje të statusit të tyre, por edhe prindërit kanë fituar pozita plotësisht të barabarta në ushtrimin e të drejtave prindërore, si ati ashtu edhe ëma.

Kjo sfidë përbën një përparim të madh të të drejtave të fëmijëve në rrugën e gjatë të evolimit historik. Qëllimi i të drejtave prindërore është përkujdesja dhe mbrojtja e fëmijëve dhe përkrahjet qëndrimi që e drejta prindërore të ushtrohet në interes të fëmijëve dhe të derivohet nga detyrimet prindërore.<sup>7</sup>

Në nenin 2 të Deklaratës për të drejtat e fëmijës (1959), përcaktohet se “ fëmija gëzon mbrojtje të veçantë dhe se i njihet me ligj apo me mjete të tjera mundësitë dhe lehtësime për një zhvillim normal dhe të shëndoshë fizik, shpirtëror, në paqe dhe dinjitet”.<sup>7</sup>

---

<sup>6</sup>Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 99

<sup>7</sup>Dr Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: vepra e cituar, faqe 183

## 2. Subjektet e së drejtës prindërore

Subjektët e së drejtës prindërore janë: a) prindërit dhe b) fëmijët.

- a) **Prindërit.**-janë persona fizik, biologjikisht të aftë për të lindur fëmijë. Nënë efëmijës konsiderohet gruaja e cila e ka lindur, ndërsa atë personi prej të cilit është zënë fëmija.<sup>8</sup>Koncepti klasik mbi prindërit: atin dhe ëmën, me zhvillimin e teknikës së re biologjike të reproduksionit të popullsisë ( fekondimi, dhurimi i qelizave vezore, dhurimi i embrionit) merr një dimenzion të ri.

Tani edhe personi me paaftësi të lindjes apo të zënies së fëmijës, si homoseksualët, me ndihmën mjeksore mund të kenë fëmijë dhe të bëhen prindër. Zënia dhe lindja e fëmijës janë fakte vendimtare mbi të cilat themelohet atësia dhe amësia si lidhje faktike.<sup>9</sup>

Kështu, shtatëzania dhe lindja e fëmijës është fakt që duket, andaj amësia themelohet me lindje. Ndërkaq, kur është fjala për vërtetimin e atësisë, rregullat ndryshojnë

---

<sup>7</sup>Deklarata.....



- varësisht prej asaj se është fjala për vërtetimin e atësisë martesore apo të atësisë jashtëmartesore.
- b) **Fëmijët.**- konsiderohen të miturit të cilët nuk kanë mbushur 18 vjet. Këtë pikëpamje e përkrah edhe e drejta jonë. Pazotësia për të vepruar e fëmijës është specifike karakteristike, e cila ia përcakton statusin e të miturit.
- Për këtë arsye, derisa të mbush moshën madhore, në qarkullimin juridik atë e përfaqësojnë prindërit si përfaqësues ligjor, apo kujdestari, nëse ai është vënë nën kujdestari. Derisa fëmija të mbush moshën madhore dhe ta fitojë zotësinë e veprimit, ai gëzon vetëm të drejta, pra jo edhe detyrime.
- c) **Vërtetimi i statusit martesor të fëmijës.**- që një fëmijë të ketë statusin e fëmijës martesor, sipas ligjit, duhet të plotësohen këto kushte:
- që fëmija të ketë preardhje nga martesa apo marrëdhëniet martesore,
  - që gruaja ta ketë lindur fëmijën në martesë, amësia martesore,
  - që i ati i fëmijës të jetë burri i nënës që ka lindur fëmijën, atësia martesore.

(1) **Preardhja martesore e fëmijës.**- Statusi martesor i fëmijëve përcaktohet me dispozita ligjore. Konsiderohet se fëmija ka lindur në martesë nëse prindërit e tij janë të martuar në kohën e lindjes së fëmijës ( neni 100 par. 1 i LFK-së ). Nëse prindërit e fëmijës së lindur jashtë martese kanë pasur qëllimin që ta lidhin martesën dhe për këtë gjë kanë qenë të penguar me vdekjen e njërit prej tyre ose me ndonjë pengesë martesore që ka lindur pas zënies së fëmijës, në bazë të kërkesës së njërit prind të fëmijës, gjykata në procedurë jashtëkontestimore do ta shpallë se fëmija ka lindur në martesë ( neni 100 par. 2 i LFK-së ).

Fëmija është martesor nëse ka lindur gjatë martesës, qoftë ajo e plotëfuqishme apo e pavlefshme.

Po ashtu, konsiderohet se fëmija ka statusin martesor në qoftë se ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës.

Koha e lindjes së fëmijës nuk është relevante. Relevant është momenti i zënies së fëmijës, ngase lindja e fëmijës në martesë do të varet nga ajo se a ka lindur brenda afatit prej 300 ditësh nga zgjidhja e martesës. Fëmija i lindur brenda këtij afati do të quhet fëmijë i lindur në martesë, edhe në qoftë se martesa është zgjidhur apo anuluar.

Fëmija do të ketë statusin e fëmijës martesor edhe po të ketë lindur menjëherë në çastet e para të lidhjes së martesës. Fëmija që ka lindur gjatë martesës prezumohet se ka për atë bashkëshortin e nënës, prandaj edhe regjistrimi i tij në regjistrat e gjendjes civile bëhet duke u shënuar si atë bashkëshorti i nënës.<sup>10</sup>

Përcaktimi i ditës së fillimit të llogaritjes së afatit prej 300 ditësh ka rëndësi relevante. Ai fillon të rrjedhë nga dita e zgjidhjes së martesës dhe përfundon me kalimin e ditës së fundit të afatit, p.sh. nëse martesa është zgjidhur me kurorëzim apo anulim, afati fillon të rrjedhë nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit për zgjidhjen apo anulimin e martesës.

Nëse martesa zgjidhet për shkak të vdekjes së njërit prind apo shpalljes për të zhdukur, llogaritja e afatit fillon të llogaritet prej ditës që me vendim gjyqësor është përcaktuar si datë e vdekjes.

Përpos kushteve që fëmija të ketë lindur gjatë martesës apo zënia e tij të jetë bërë gjatë ekzistimit të lidhjes martesore, për ta gëzuar statusin martesor fëmijës duhet t'i dihen atësia dhe amësia.

- (2) Vërtetimi i amësisë martesore.-** Që fëmija të ketë statusin e fëmijës martesor është e nevojshme ta ketë lindur gruaja, e cila në momentin e lindjes së fëmijës ka qenë në martesë.<sup>11</sup>Për shkak se shtatëzania dhe lindja e fëmijës janë ngjarje të dukshme, shumë rrallë ndodh në praktikën gjyqësore që të paraqiten padi për vërtetimin e amësisë.

Rregulla e vjetër e së drejtës romake se nëna është gjithmonë e njohur (mater semper certa est.) është edhe sot aktuale dhe përkrahet nga rregullativa jonë ligjore, por edhe e shumë vendeve të tjera.

Rastet më të shpeshta që kanë të bëjnë me vërtetimin e amësisë te ne janë ndërrimi i foshnjave të sapolindura në shërbimet e maternitetit, apo shënimi gabimisht i emrit të një gruaje tjetër në vend të emrit të nënës së vërtetë në librat e gjendjes civile.

Së fundi, prezumohet se gruaja e cila ka lindur fëmijën është edhe nëna e vërtetë e tij, dhe ky fakt regjistrohet në librat e amzës për të lindurit. Sikurse edhe shënimet e tjera të regjistruara në librat e gjendjes civile, edhe ky shënim konsiderohet i saktë, derisa nuk vërtetohet e kundërta.<sup>12</sup>

---

<sup>8</sup>Dr Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic: vepra e cituar, faqe 189

<sup>9</sup>Po aty, faqe 189

<sup>10</sup>Santhipi Begeja, vepër e cituar, faqe 163 (citoje komplet se eshte hera e pare)

<sup>11</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 223citoje komplet se eshte hera e pare)

<sup>12</sup>Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 107

- (3) Vërtetimi i atësisë martesore.-** Elementi i tretë i statusit të fëmijës është atësia martesore. Dy janë kushtet më të rëndësishme për vërtetimin e atësisë së fëmijës: ekzistimi i martesës në momentin e lindjes së fëmijës dhe ekzistimi i martesës në momentin e zënies së fëmijës.

Nga kjo rezulton prezumimi se atë i fëmijës është burri i nënës së fëmijës, e cila në momentin e lindjes së fëmijës, apo zënies së tij, ka qenë në lidhje martesore.

Në literaturën juridike është debatuar mjaft rreth vërtetimit të atësisë, kur zënia e fëmijës nuk mund të bëhet në mënyrë natyrore për shkak të paaftësisë seksuale (impotentiae cocundi), apo të sterilitetit (impotentiae generandi) të burrit, por mbarësimi është kryer me rrugë artificiale dhe me asistencë mjekësore.

Në literaturën juridike sundon mendimi se kur gruaja e martuar mbetet shtatzënë me qeliza vezore të fekunduara të burrit të nënës së fëmijës, në mënyrë artificiale (i ashtuquajtur i mbarësim homologjen), atëherë atë i fëmijës është burri i nënës së fëmijës e cila e lindi fëmijën. Shtatëzania homologjene e gruas është e lejuar dhe e përkrahur si një mënyrë e mënjanimi të sterilitetit të martesës.<sup>13</sup>

Mirëpo, nëse gruaja nuk ka mbetur shtatzënë me qelizat e burrit martesor të saj, por me qelizat e një burri tjetër jashtëmartesor-donatorit (frytnimi homologjen), çështja del mjaft e ndërlikuar. Me këtë rast, burri i nënës së fëmijës nuk është atë natyror i fëmijës. Nëse burri i nënës së fëmijës pajtohet me shkrim me këtë mënyrë të zënies së fëmijës, prezumohet si atë social i fëmijës. Më pastaj, ky edhe juridikisht njihet si atë i fëmijës.

Së fundi, edhe sipas rregullës së parë, se të gjithë fëmijët e lindur gjatë vazhdimi të martesës janë fëmijë martesorë dhe atë kanë burrin e nënës që i lindi, ashtu edhe sipas rregullës së dytë, se fëmija i cili ka lindur brenda 300 ditësh pas zgjidhjes apo anulimit të martesës është fëmijë martesor, del saksisht se atë i prezumuar është burri i nënës e cila e lindi fëmijën.

---

<sup>13</sup>Po aty, faqe 235

### **3. Rëndësia e amësisë dhe e atësisë së fëmijës**

Amësia dhe atësia e personit, së bashku me emrin, mbiemrin, shtetësinë, kombësinë dhe përbërës të tjerë të gjendjes civile<sup>14</sup>, të cilët, në mënyrë të shkurtuar, mund t'i klasifikojmë edhe si të dhëna vetjake të personit, janë të drejta jopasurore, që mund t'i gëzojë vetëm qenia njerzore që ka lindur e gjallë.

Nga ana tjetër, amësia dhe atësia e fëmijës, duke u përfshirë në identitetin e personit, shërbejnë për të krijuar statusin e tij vetjak, i cili do ta personifikojë personin, që nga çasti i lindjes së tij, si dhe gjatë gjithë jetës. Statusi vetjak gëzon mbrojtjen e legjislacionit vendës dhe atij

ndërkombëtar, jo vetëm për shkak të lidhjeve të drejtëpërdrejta me interesa të rëndësishëm privatë dhe publikë, por edhe për faktin se është konsideruar interes dhe e drejtë themelore e rangut të parë, çka e gjejmë të sanksionuar shprehimisht nga Konventa “Për të drejtat e fëmijës”,<sup>15</sup>

Amësia dhe atësia e fëmijës janë, gjithashtu, dy elemente që kanë rëndësinë e tyre edhe për të përcaktuar origjinën dhe përkatësinë familjare të një personi, përfshi këtu dhe raportet prindërore mëmë-bir/bijë dhe atë-bir/bijë. Në këtë këndvështrim është me interes të sqarojmë se termi raporte prindërore, nga pikëpamja juridike, mbart dy kuptime:

- **së pari**, kuptimin e përcaktimit të një lidhjeje fakti midis prindërve dhe fëmijëve të tyre;
- **së dyti**, kuptimin material të tërësisë së të drejtave e detyrimeve që karakterizojnë lidhjen midis prindërve dhe fëmijëve të tyre.

Në këtë trajtim teorik të çështjes, paraqet interes, kuptimi i parë i termit në fjalë, pra kuptimi që ka të bëjë me lidhjen faktike midis prindërve dhe fëmijëve të tyre.

Këto raporte prindë-fëmijë janë veçanërisht tepër të rëndësishme për fëmijët e mitur, për disa arsye juridike, jetësore dhe shoqërore, të cilat mund t’i guponim si më poshtë:

- Sepse, në kushtet e papjekurisë fizike dhe intelektuale, fëmijët kanë nevojë për varësi nga prindërit e tyre.
- Sepse mungesa e zotësisë për të vepruar nuk i lejon ata të jenë palë në marrëdhëniet juridiko-civile.
- Për shkak se fëmijët përfaqësojnë interes parësor për prindërit, si dhe janë vazhdimësia e jetës për familjen dhe shoqërinë.

Përcaktimi i përkatësisë familjare të personit është i lidhur dhe duhet konsideruar edhe si pjesë përbërëse e së drejtës për një jetë familjare normale, e cila ka gjetur trajtim nga një sërë aktesh ndërkombëtare, por edhe nga Kushtetuta jonë, e cila, duke përcaktuar në nenin 53/2 të saj se “martesa dhe familja gëzojnë mbrojtjen e veçantë të shtetit”, ka treguar jo vetëm rëndësinë e veçantë të këtyre instituteve për shtetin dhe shoqërinë, por dhe rëndësinë e raporteve të individit me martesën dhe familjen e tij.

Në mënyrë të veçantë, neni 8/1 i Konventës “Për të drejtat e fëmijës”, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, ka përcaktuar se “lidhjet familjare” janë pjesë e identitetit të fëmijës.<sup>16</sup>

---

<sup>14</sup>Shih nenin 10 të ligjit nr.8950, date 10.10.2002, “Për gjendjen civile”.

<sup>15</sup>Aurela Anastasi, Çështje të njohjes së atësisë në kuadrin e të drejtës për një jetë familjare normale, Tiranë, 2004, revista “Ligji-mundësi zhvillimi për gratë”, nr.14.

<sup>16</sup>Konventa e OKB-së “Për të drejtat e fëmijës”, neni 8, pika 1”Shtetet palë angazhohen të respektojnë të drejtë e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, ashtu siç njihen nga ligji, pa ndërhyrje të paligjshme”.

Brenda lidhjeve familjare, atësia dhe amësia e personit janë dy elemente juridike shumë të rëndësishëm dhe përcaktuese në raportin prindër-fëmijë, sepse nga këto raporte lindin të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta, përgjegjësitë juridike e morale të prindërve ndaj fëmijëve të tyre dhe anasjelltas, të cilat garantohen me forcën shtrënguese të ligjit.

Duhet të themi se problematikat që lidhen me amësinë dhe atësinë e personit janë analizuar nga shumë këndvështrime, p.sh., duke u mbështetur në mënyrën e përcaktimit të amësisë dhe atësisë, krijohen dy ndarje, të cilat i quajmë “mënyra e prokreimit”, që bazohet në situatën juridike ose faktike nëpërmjet të cilës fëmija është konceptuar dhe ka lindur ose “mënyra e caktimit formal” që nënkupton përcaktimin e amësisë ose të atësisë nëpërmjet verifikimit, hulumtimit të

momentit gjenetik të konceptimit (vërtetimi gjyqësor i amësisë ose atësisë) ose caktimi sipas ligjit (atësia dhe amësia e fëmijës së birësuar).

Një ndarje tjetër është dhe ajo që nisët nga statusi martesor i nënës së fëmijës dhe që e lidh përcaktimin e amësisë dhe të atësisë së një fëmije me grupimin e tyre në “fëmijët e ligjshëm”, ku përfshihen ata të lindur nga një nënë me status civil “e martuar” dhe “fëmijë natyrorë”, ata fëmijë që kanë lindur nga një nënë me status civil “beqare” ose e pamartuar (Këtë gjendje të lindjes së fëmijës mund ta gjejmë të përcaktuar edhe me shprehjet “fëmijë nga martesa” dhe “fëmijë jashtë martese”).

Legjislacioni familjar shqiptar duket se ka pranuar elemente nga të dyja këto shkolla, por, gjithsesi, ka ofruar zgjidhje që të respektojnë parimin e interesit më të lartë të fëmijës dhe të drejtë e tij për një identitet të përcaktuar dhe të pandryshueshëm pa shkaqe ligjore.

#### **4. Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesa**

Lindja e një fëmije në mënyrën tradicionale nënkupton origjinën e tij prej një nëne dhe një ati por, si në këndvështrimin ligjor, ashtu edhe në atë praktik, fakti nëse fëmija ka lindur nga prindër që janë të lidhur apo jo me martesë, merr shumë rëndësi për mënyrën e përcaktimit të raporteve të tij me prindërit.

Për fëmijën e lindur nga martesa, përcaktimi i amësisë dhe atësisë së tij janë të lidhura, sa me faktin juridik të lindjes së tij, ashtu edhe me prezumimet ligjore, të cilat e kanë bazën në lidhjen martesore të prindërve të tij.

Lidhur me këtë çështje, Kodi i Familjes në nenin 165 të tij, përcakton: “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesë provohet nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile”. Nga ky përcaktim ligjor, dalin në pah tre elemente, të cilat janë tepër të rëndësishme lidhur me çështjen që po trajtojmë:

- Së pari, në kuadër të përcaktimit të atësisë e të atësisë së fëmijës, evidentohet akti i lindjes si një akt administrativ i pazëvendësueshëm.
- Së dyti, përcaktohet se amësia dhe atësia e një fëmije të lindur nga një martesë, në kuptimin ligjor, janë vetëm ato që shënohen në aktin e lindjes.
- Së treti, akti i lindjes përbën një akt me vlera të plota vetëm kur është regjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Vërejmë se neni 165 i Kodit të Familjes na referon tek akti i lindjes, kur bëhet fjalë për mënyrën e përcaktimit të amësisë dhe atësisë së fëmijës të lindur nga martesë, ndërkohë që vetë kodi nuk përmban dispozita ligjore të hollësishme që do të shpjegojnë si përpilohet ky akt. Për krijimin dhe regjistrimin e aktit të lindjes ekziston një ligj i veçantë dhe, konkretisht, ligji nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”.

Sipas këtij ligji, përpilimi i aktit të lindjes është kompetencë e nëpunësit të gjendjes civile dhe, për këtë qëllim ai duhet të mbështetet në dy elemente të rëndësishme e të domosdoshme, të cilat janë:

1. Dokumenti bazë i lindjes;
2. Deklarimi i lindjes që i bëhet nëpunësit të gjendjes civile prej personave të autorizuar nga ligji.

Secili nga këto dy elemente, i pashoqëruar me elementin tjetër, nuk do të ishte i mjaftueshëm, që nëpunësi i gjendjes civile të përpilonte dokumentin administrativ, të cilin ligji e ka titulluar “akti i lindjes”. Duke pranuar rëndësinë e madhe të dy elementeve të sipërsëhënuara, le të ndalemi në kuptimin e secilit prej tyre.

- Dokumenti bazë i lindjes

Ligji “Për gjendjen civile” ka trajtuar me shumë kujdes mënyrën e hartimit të dokumentit që provon lindjen si fakt për një fëmijë, si dhe personat që mund ta përpilojnë atë, pa anashkluar të japë zgjedhjet e nevojshme edhe në rastet kur lindja ndodh pa praninë e ndonjë personi, ose kur fëmija i sapolindur gjendet i braktisur nga persona të panjohur e që nuk kanë asnjë lidhje familjare me të. Këtë dokument ligji e ka titulluar “dokumenti bazë i lindjes”.

Janë pikërisht nenet 32 e 33 të ligjit “Për gjendjen civile” që e bejnë këtë rregullim. Sipas këtyre dispozitave, autoritetet që mund të përpilojnë dokumentin që provon lindjen si fakt të një fëmije janë:

- Mjeku ose personeli mjekësor që ka asistuar lindjes;
  - I ngarkuari nga pushteti vendor;
  - Kapiteni i trenit, i anijes ose i avionit;
  - Komandanti i burgut ose i repartit ushtarak;
  - Zyrtarë të përfaqësive diplomatike të vendit tonë të akredituara jashtë shtetit.
- Deklarimi i lindjes që i bëhet nëpunësit të gjendjes civile prej personave të autorizuar nga ligji.

Deklarimi i lindjes së fëmijës, siç kemi përmendur më lart, është veprimi i dytë i domosdoshëm që kushtëzon përpilimin e ‘‘aktit të lindjes’’. Nga përmbajtja e nenit 34 të ligjit të sipërshtetë del se ky deklarim nënkupton një komunikim të drejtëpërdrejtë gojor midis personave të autorizuar nga ligji për këtë qëllim dhe nëpunësit të gjendjes civile.

Ky komunikim ka për qëllim t’i japë mundësi nëpunësit të gjendjes civile që, sipas rastit, të bëjë verifikime të mëtejshme e të domosdoshme, kur ai nuk krijon bindje nga përmbajtja e ‘‘dokumentit bazë të lindjes’’, përpara se të përpilojë ‘‘aktin e lindjes’’ dhe ta regjistrojë atë në regjistër.

Po kush mund ta bëjë deklarin e lindjes së fëmijës? Ligji ‘‘Për gjendjen civile’’ përcakton se, si rregull, deklarimi i lindjes së fëmijës bëhet nga njëri ose të dy prindërit e tij, por, në ligj, në nenin 34 të tij, është parashikuar që ky deklarim mund të bëhet edhe nga pjestarë të tjerë madhorë të familjes, nga përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët e prindërve të fëmijës dhe, në mungesë të tyre, edhe nga personat që kanë përpiluar ‘‘dokumentit bazë të lindjes’’, pra të gjithë ata që përmenden nga nenet 32 e 33 të ligjit në fjalë dhe që i trajtuam më sipër.

Ligji, si rregull, nuk lejon që ky deklarim të mund të bëhet me mjete shkresore, qofshin ato të thjeshta, zyrtare ose akte noteriale. Bën përjashtim nga rregulla e mësipërme nëna e fëmijës, së cilës vetë ligji i ka lejuar që të mund ta bëjë deklarin e lindjes së fëmijës së saj nëpërmjet një përfaqësuesi të pajisur për këtë qëllim me prokurë ose nëpërmjet një personi të autorizuar prej saj, kur ajo gjendet në pamundësi fizike.<sup>17</sup>

---

<sup>17</sup>Prof. As. Dr. Arta Mandro-Balili, Bashkëjetesa e faktit fq.496

## **5. Përcaktimi (vendosja) i amësisë dhe i atësisë së fëmijës së lindur jashtë martese**

### **• Kuptimi i fëmijës së lindur jashtë martese**

Në përcaktimin e një fëmije si të lindur jashtë martese kanë rëndësi një sërë rrethanash, por në mënyrë të veçantë statusi civil i nënës në kohën kur e ka konceptuar fëmijën dhe veçanërisht kur e ka lindur atë. Megjithatë, për të kuptuar se kë duhet të konsiderojmë ‘‘fëmijë të lindur jashtë martese’’, në radhë të parë, na vjen në ndihmë vetë termi i përdorur për këtë qëllim. Brenda këtij

termi dalin në pah dy momente të rëndësishëm: së pari, që duhet të ekzistojë një fëmijë i lindur (një qenie njerzore e lindur gjallë) dhe së dyti, që kjo lindje nuk duhet të ketë lidhje ligjore me një martesë konkrete.

Në kuptimin e të drejtës familjare, do të konsiderohet fëmijë i lindur jashtë martese çdo fëmijë i lindur nga një grua e panjohur, nga një grua që nuk ka qenë e martuar ligjërisht asnjëherë, ose kur kanë kaluar më shumë se 300 ditë nga martesa e saj e fundit ose kur me vendim të formës së prerë fëmijës i është çnjohur atësia që i ishte përcaktuar nga zbatimi formal i ligjit.

Fakti i të qenit fëmijë i lindur jashtë martese nuk gjen pasqyrim në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktet e gjendjes civile të fëmijës, me qëllim që të mos krijojë kushte për diskriminimin e tij. Në të kundërt, Kushtetuta e R. së Shqipërisë dhe legjislacioni familjar kanë përcaktuar se fëmijët e lindur jashtë martese kanë të njëjtat të drejta e detyra si fëmijët e lindur nga martesa.

- **Institutet ligjore për përcaktimin (vendosjen) e amësisë dhe atësisë së fëmijës së lindur jashtë martese**

Institutet ligjore për përcaktimin ose vendosjen e amësisë dhe të atësisë së fëmijës së lindur jashtë martese, në kuptimin e të drejtës për të vënë në lëvizje një organ, i cili do të shqyrtojë e do të vendosë në lidhje me kërkesën e subjekteve të legjitimuara nga ligji për këtë qëllim, i gjejmë të shprehura në nenin 170 të Kodit të Familjes. Në këtë vazhdim dispozitë midis të tjerave, thuhet: “amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martese mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor...”. Nga përmbajtja e dispozitës del e qartë se, subjektet e legjitimuara, për të kërkuar përcaktimin e amësisë ose të atësisë së një fëmije të lindur jashtë martese. Si rregull, kanë të drejtë të përdorin nismën e tyre për ta zgjidhur çështjen ose me rrugë vullnetare, ose nëpërmjet forcës shtrënguese të vendimit gjyqësor.

Amësia dhe atësia e një fëmije nuk është një e drejtë që buron nga martesa e prindërve të tij, por një e drejtë që e ka bazën në bashkëveprimin e prindërve për lindjen e fëmijës së tyre dhe ky bashkëveprim mund të kryhet, si gjatë martesës, por edhe jashtë saj. Forma vullnetare e ndërhyrjes për përcaktimin e amësisë dhe të atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese mund të ushtrohet vetëm përpara organeve administrative, konkretisht përpara nëpunësit të gjendjes civile. Ligji ka njohur dy mjete të deklarimit vullnetar të atësisë ose të amësisë së një fëmije të lindur jashtë martese: deklarimin për para nëpunësit të gjendjes civile dhe testamentin.

Së fundi, duhet të nënvizojmë se mjetet vullnetare ose shtrënguese për përcaktimin e amësisë ose të atësisë së një fëmije mund të ushtrohen vetëm për një fëmijë që ka lindur i gjallë por vendimi i gjykatës për këtë qëllim ka fuqi prapavepruese, ai i shtrin efektet e tij që nga lindja e fëmijës.

- **Amësia e fëmijës së lindur jashtë martese**

Përcaktimi i amësisë së fëmijës së lindur jashtë martese është i lidhur me qëndrimin e nënës dhe vullnetin e saj për të përmbushur me saktësi procedurat e nevojshme administrative, të cilat shërbejnë për përpilimin e dokumentit bazë të lindjes dhe të aktit të lindjes.

Siç mund të vërejmë qenia e martuar ose jo e gruas në këtë rast nuk ndikon në përcaktimin e amësisë së fëmijës së lindur prej saj, por ndërkohë mbetet faktor i rëndësishëm njohja faktike që gruaja i bën fëmijës që nga çasti i lindjes e deri në përpilimin e regjistrimit të aktit të lindjes së



tij. Çfarë kuptojmë me temin njohje faktike të fëmijës? Kuptojmë veprimet e vullnetshme të gruas e cila e ka lindur fëmijën për ta pranuar atë si të saj të paktën për periudhën deri në përfundimin e procedurave të përpilimit të aktit të lindjes e regjistrimin e tij.

Njohja faktike e fëmijës nga nëna manifestohet nëpërmjet sjelljeve të tilla si: mosfshehja e faktit të lindjes, mosndarja e vullnetshme e saj nga fëmija, bashkëpunimi i sinqertë me autoritetet përkatëse të ngarkuar nga ligji për përpilimin e dokumentacionit administrativ që shërben për regjistrimin e fëmijës etj.

Ç’ndodh me një fëmijë të braktisur nga nëna përpara se të jetë përpiluar akti i lindjes së tij? Ky fëmijë pasi gjendet do të regjistrohet nga zyra e gjendjes civile që mbulon territorin e vendit ku është gjetur fëmija, por me amësi të panjohur, sa kohë që asnjë grua nuk deklaron vullnetarisht për këtë qëllim.

- **Njohja vullnetare nga nëna e fëmijës së lindur jashtë martesë dhe vërtetimi gjyqësor i amësisë**

Me përfundimin e përpilimit të aktit të lindjes së një fëmije dhe me regjistrimin e tij në regjistrin themeltar të shtetasve me amësi të panjohur ose kur kalon afati 45 – ditor i parashikuar nga ligji “Për gjendjen civile” për deklarimin e lindjes dhe për regjistrimin e tij, si dhe kur fëmijambetet i pa regjistruar, nënës nuk i humbet e drejta për ta njohur atë fëmijë dhe për t’i vendosur atij emrin e vet si amësi.

Për të realizuar njohjen e saj si nënë e një fëmije të regjistruar me nënë të panjohur ose të paregjistruar ende Kodi i familjes nëpërmjet neneve 169, 170, 176 i ka njohur nënës, për se gjalli dy rrugë: së pari, rrugën administrative nëpërmjet deklarimit vullnetar përpara nëpunësit të gjendjes civile dhe së dyti, nëpërmjet rrugës gjyqësore.

Rrugën gjyqësore për vërtetimin e amësisë mund ta ushtrojë edhe vetë fëmija kur bëhet madhor. Kjo e drejtë nuk i parashkruhet atij gjatë gjithë jetës, por ajo nuk përbën një të drejtë që mund të trashëgohet. Gjithsesi, trashëgimtarët sipas par. 2 neni 177 të Kodit të Familjes mund të vazhdojnë gjykimin e filluar nga fëmija me gjalljen e tij.<sup>18</sup>

---

<sup>18</sup>Prof. As. Dr. Arta Mandro-Balili, Bashkëjetesa e faktit fq.515

## **6. Kundërshtimi i amësisë**

Në praktikën gjyqësore janë të rralla paditë për kundërshtimin e amësisë. Sepse, të pakta janë rastet kur mbetet e panjohur preardhja e fëmijës prej nënës, kur e lind gruaja martesore. Nëna si rregull, është gjithmonë e njohur që nga momenti i zënies, bartjes së shtatëzanisë dhe lindjes së fëmijës.<sup>19</sup>

Nëna e fëmijës regjistrohet në librat e amzës me rastin e regjistrimit të fëmijës së lindur. Megjithatë, prezumimi se nëna e fëmijës e regjistruar në librat amzë për të lindurit është nëna natyrore e fëmijës nuk është gjithmonë i saktë.

Praktika ka treguar edhe të kundërtën, se nëna e fëmijës, e regjistruar në librat civilë, nuk është gjithmonë edhe nëna natyrore e fëmijës. Të tilla raste ndodhin me rastin e ndërrimit të foshnjave në shërbimet e maternitetit, qoftë me apo pa qëllim.

Ose kur gjatë lindjes vdes nëna e fëmijës, kurse fëmija mbetet në jetë dhe një nënë tjetër, të cilës i ka vdekur foshnja e saj gjatë lindjes, e merr foshnjën jashtëmartesore të mbetur gjallë për të veten. Apo, rasti kur nëna e braktis fëmijën.

Prandaj, qëllimi i kundërshtimit të amësisë është që të vërtetohet nëna e vërtetë, natyrore e fëmijës, e cila e ka lindur atë, ndërsa gruaja e regjistruar si nënë e fëmijës në amzën e të lindurve në bazë të njohjes, nuk është nëna natyrore e fëmijës së lindur.

- 1. E drejta e padisë për kundërshtimin e amësisë.**- Padinë për kundërshtimin e amësisë kanë të drejtë ta paraqesin këta persona: gruaja e regjistruar në regjistrat amzë të të lindurve si nënë e fëmijës (nëna e prezumuar), gruaja e cila veten e konsideron nënë të fëmijës dhe fëmija.
- 2. Kundërshtimi i amësisë nga gruaja e cila është regjistruar në regjistrin amë të të lindurve si nënë e fëmijës.**- Gruaja e cila është regjistruar në regjistrin amë të të lindurve si nënë e fëmijës mund ta kundërshtojë amësinë e vet nëse konsideron se nuk është nënë e fëmijës (neni 118 i LFK-së). Padia për kundërshtimin e amësisë nga ana e nënës së prezumuar mund të paraqitet brenda afatit 6-mujor nga dita kur merr në dijeni faktin se ajo nuk është nëna e fëmijës, por jo më shumë se 7 vjet nga lindja e fëmijës. Përrjashtimisht, edhe gruaja e cila e ka lindur fëmijën e zënë me qelizën vezore të një gruaje tjetër ka të drejtë të kundërshtojë amësinë, nëse mbarsja është bërë me asistencë mjekësore dhe pa pëlqimin me shkrim të saj (neni 124 par. 2 i LFK-së).
- 3. Kundërshtimi i amësisë nga gruaja e cila e konsideron veten nënë të fëmijës.**- Gjithashtu, mund ta kundërshtojë me padi amësinë e nënës së prezumuar edhe gruaja e cila e konsideron veten nënë të fëmijës. Padinë për kundërshtimin e amësisë ajo mund ta paraqesë brenda afatit prej 6 muajsh nga marrja në dijeni se ajo është nënë e fëmijës, por jo më vonë se 7 vjet nga lindja e fëmijës. Mund të thuhet se padia e gruas, e cila e kundërshton amësinë e nënës së prezumuar, në të vërtetë përmban dy kërkesëpadi: me të parën kundërshtohet amësia e nënës së prezumuar, kurse me të dytën kërkohet vërtetimi i amësisë së vet për fëmijën.
- 4. Kundërshtimi i amësisë nga fëmija.**- Edhe fëmijët kanë të drejtë të paraqesin padi për kundërshtimin e padisë, sepse ata janë më të interesuarit ta dinë se prej cilës nënë e kanë preardhjen dhe cila është vërtetë nëna e tyre natyrore.

---

<sup>19</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 237

## **7. Kundërshtimi i atësisë**

Qëllimi i kundërshtimit të atësisë është që të vërtetohet se burri i nënës së fëmijës nuk është edhe atë i fëmijës. Prezumimi juridik, i njohur në literaturën juridike se burri i nënës së fëmijës është edhe atë i fëmijës, nuk është përherë i qëndrueshëm<sup>20</sup>.

Burri mund të kundërshtojë atësinë e fëmijës të cilin e ka lindur gruaja e tij gjatë martesës apo kalimit të 300 ditëve nga zgjidhja e martesës, nëse konsideron se nuk është atë i fëmijës (neni

113, par. 1 i LFK-së). Atësinë mund ta kundërshtojnë: nëna e prezumuar e fëmijës, fëmija, personi që e konsideron veten për atë të fëmijës jashtëmartesor dhe burri i nënës së fëmijës.

- 1. Kundërshtimi i atësisë nga nëna e prezumuar e fëmijës.-** Nëna e fëmijës është po ashtu e interesuar për kundërshtimin e atësisë nëse merr në dijeni faktin se i ati i prezumuar nuk është atë natyror i fëmijës. Padia për kundërshtimin e atësisë nga nëna duhet të paraqitet brenda afatit prej 6 muajsh nga lindja e fëmijës ( neni 114, par. 2 i LFK-së).
- 2. Kundërshtimi i atësisë nga fëmija.-** Fëmija mund ta kundërshtojë atësinë e personit i cili, në bazë të ligjit, konsiderohet si i ati i tij (neni 115 par. 1 i LFK-së). Nëse fëmija është i mitur ose nuk ka aftësi për të vepruar, padinë në emër të tij mund ta paraqesë nëna, e nëse nëna nuk është e gjallë ose ka vendqëndrim të panjohur apo i është hequr e drejta prindërore ose aftësia për të vepruar, padinë mund ta paraqesë kujdestari, me lejen e organit të kujdestarisë (neni 115, par. 2 i LFK-së).
- 3. Kundërshtimi i atësisë nga personi që e konsideron veten atë të fëmijës jashtëmartesor.-** LFK-ja njeh të drejtën për kundërshtimin e atësisë edhe të personave jashtëmartesorë, nëse ata konsiderojnë se janë etër natyrorë të fëmijës. Neni 116 i LFK-së parasheh: "Personi që e konsideron veten atë i fëmijës së lindur jashtë martesës mund të kërkojë pavlefshmërinë e atësisë të personit tjetër, i cili atë fëmijë e ka pranuar si të vetin, me kusht që po me atë padi të kërkojë që të vërtetohet atësia e tij". Paraqitja e padisë mund të bëhet brenda afatit prej një (1) viti nga regjistrimi i atësisë së kundërshtuar në regjistrin amë të të lindurve.
- 4. Kundërshtimi i atësisë nga burri i nënës së fëmijës.-** Burri i nënës së fëmijës gjithashtu ka interes të vërtetojë se fëmija që ka lindur gruaja e tij martesore nuk është i tij. Padia për të kundërshtuar atësinë mund të paraqitet brenda afatit prej 6 muajsh nga dita e marrjes në dijeni të faktit që vë në dyshim atësinë e tij (neni 113, par. 2 i LFK-së). Kundërshtimi i atësisë dhe i amësisë nuk lejohet pas vdekjes së fëmijës. Këtë e parasheh dispozita e nenit 122 të LFK-së.

E drejta e kundërshtimit të atësisë dhe amësisë mund të ushtrohet vetëm në rrugë gjyqësore dhe me ligj. Kjo e drejtë i është njohur jo vetëm nënës dhe atit të përcaktuar si të tillë, vetë fëmijës kur ai është bërë madhor, por edhe nga çdo personi që provon se ka një interes të ligjshëm për këtë qëllim dhe, së fundi, edhe prokurorit.

Mund të kërkohet kundërshtimi i amësisë ose i atësisë të përcaktuar për një fëmijë sipas procedurës normale administrative ose të njohur vullnetarisht prej prindërve<sup>21</sup>.

---

<sup>20</sup>Dr. Sc. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, fq.158

<sup>21</sup>Prof. As. Dr. Arta Mandro-Balili, Bashkëjetesa e faktit, fq.530

## **8. Procedura për kundërshtimin e atësisë**

Në kontestet lidhur me kundërshtimin dhe vërtetimin e atësisë dhe të amësisë zbatohen rregullat e procedurës civile. Për shkaqe të moralit dhe të ruajtjes së interesave të fëmijëve, nga shqyrtimi gjyqësor përjashtohet publiciteti. Disa veprime procedurale gjykata i kryen ex officio, pa marrë parasysh qëndrimet e palëve<sup>22</sup>.

As vendimi i gjykatës nuk varet gjithmonë nga kërkesat e palëve<sup>23</sup>. Andaj edhe thuhet se në procedurën bashkëkohore kombinohen parimi i disponibilitetit dhe oficialitetit<sup>24</sup>.

Gjykata duhet t'i vërtetojë faktet edhe kur ato midis palëve nuk janë kontestuese dhe kur fëmija është madhor. Për këtë, gjykata në procedurë për kundërshtimin e atësisë nuk mund të nxjerrë aktgjykim në bazë të pohimit, për shkak të mungesës apo të lidhet marrëveshja gjyqësore.

Palët në procedurë janë: burri i nënës së fëmijës, nëna e fëmijës dhe fëmija. Kur padia ngrihet nga njëra prej këtyre palëve, p.sh. nga nëna e fëmijës, me padi duhet të përfshihen edhe dy palët tjera, burri i nënës së fëmijës dhe fëmija.

Padia do të hidhet poshtë nëse paditësi nuk e zgjeron atë edhe ndaj palëve të tjera në afatin e caktuar nga gjykata, nëse ato paditësi fillimisht nuk i ka përfshirë me padi.

Në procedurën për kundërshtimin e atësisë merren këto prova: a) provat juridike dhe b) provat mjeko-ligjore.

- a) Provat juridike.- Me këto prova vërtetohet koha e zënies së fëmijës. Dallimi mes shtatëzaniës më të shkurtër se 180 ditë dhe asaj më të gjatë se 300 ditë përbën periudhën kritike të zënies së fëmijës, e cila zgjat 120 ditë.

Kjo rrethanë vërteton nëse nëna e fëmijës me burrin e saj martesor kanë jetuar të ndarë në kohën e zënies së fëmijës, p.sh. burri i nënës së fëmijës ka qenë me punë të përkohshme në botën e jashtme, në burg për shkak të vuajtjes së dënimit ose i shtrirë në spital për shkak të sëmundjes etj., gjë që përjashton mundësinë që burri i nënës së fëmijës të jetë atë i fëmijës.

Për ta vërtetuar saktësisht dhe drejt gjendjen materiale, gjykata merr edhe mjete tjera provuese, si: dëshmitë e dëshmitarëve me ndihmën dhe konstatimin e ekspertëve mjeko-ligjorë, etj.

---

<sup>22</sup>Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, ETMMKSAAK, Prishtinë, 2000, faqe 55

<sup>23</sup>Po aty, faqe 55

<sup>24</sup>Po aty, faqe 55

- b) Provat mjeko-ligjore.- Edhe me këto prova mund të vërtetohet lehtë se i ati i prezumuar i fëmijës nuk është ati natyror (biologjik) i fëmijës. Grupet e gjakut dhe faktorët e gjakut kanë marrë gjithashtu rëndësi të madhe në procedurën e kundërshtimit të atësisë. Grupe themelore të gjakut janë: A, B, AB dhe 0.

Ndërsa nëngrupet janë: A1, A2, B1, B2 etj., por rëndësi të veçantë ka faktori RH dhe ai mund të jetë pozitiv apo negativ. Me kombinime të faktorëve të gjakut dhe të grupeve të

gjakut përjashtohet mundësia që burri i nënës së fëmijës të jetë edhe i ati i fëmijës. P.sh, kur vërtetohet se fëmija ka grupin e gjakut AB, prindërit duhet ta kenë patjetër grupin A dhe B.

Në qoftë se burri i nënës së fëmijës nuk ka as njërin nga këto grupe, pra as A as B, por grupin 0, vërtetohet saktësisht se ai nuk është ati i fëmijës. Analizat e grupeve të gjakut dhe të faktorëve të gjakut, veçanërisht në vendet perëndimore me shkallë të lartë të zhvillimit të mjeksisë ligjore, kanë treguar se sa i përket përjashtimit të mundësisë për të qenë atë i fëmijës, ato janë të sakta deri 99,9 per qind.

Metodat antropologjike bazohen në tiparet karakteristike somatike të trashëguara të fëmijës. Me anë të këtyre tipareve vërtetohet në masë të madhe apo më të vogël se kush është i ati i fëmijës. Të tilla janë: shenjat e ndryshme trupore, anomalitë e trashëguara, sëmundjet, raca etj.

Me institucionalizimin dhe krahasimin e tyre me tiparet e të atit shumë lehtë mund të vërtetohen ngjajshmëritë mes fëmijës dhe të atit.

Megjithatë, këto prova nuk janë mjaft të sigurta dhe nuk mund të vërtetohet në bazë të tyre saktësisht se burri i nënës së fëmijës nuk është i ati i fëmijës.

## **9. Pasojat e kundërshtimit të atësisë**

Është i karakterit konstitutiv aktgjykimi me të cilin në mënyrë të suksesshme është kundërshtuar atësia, për shkak se me të ndryshohen marrëdhëniet juridike mes palëve<sup>25</sup>.

Ofiqari i gjendjes civile duhet t'i bëjë ndryshimet në regjistrat amë të të lindurve, duke qenë se edhe ky aktgjykim, sikurse çdo aktgjykim tjetër, me të cilin vendoset mbi të drejtat statusore, krijon efekte erga omnes, dmth. vepron ndaj të gjithëve.

Fëmija me këtë rast ndryshon statusin, prej fëmijës me status martesor, ai kalon në fëmijë me status jashtëmartesor, dhe i ati i tij natyror tani nuk dihet. Ai humb të gjitha të drejtat të cilat i kishte ndaj të atit të tij të prezumuar.

Vetëm me rastin kur i ati natyror me sukses kundërshton atësinë e atit të prezumuar dhe vërtetohet atësia e tij, fëmija e ka të vërtetuar atësinë jashtëmartesore<sup>26</sup>.

Fëmijët jashtëmartesor dhe martesorë tani janë plotësisht të barabartë në pikëpamje të të drejtave dhe detyrimeve.

Ai barazohet me të afërmit në gjini të të atit të vërtetuar dhe në pikëpamje të trashëgimisë, ushqimit të detyruar, mbiemrit etj. Siç shihet, ai fiton të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj të atit të tij natyror, të vërtetuar me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës.

---

<sup>25</sup>Po aty, faqe 202

<sup>26</sup> Po aty, faqe 202

### **KAPITULLI III**

## **POZITA JURIDIKE E FËMIJËVE JASHTËMARTESORË NË SISTEMIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

### **1. Nocioni i fëmijëve jashtëmartesorë**

Fëmijët jashtëmartesorë për një kohë të gjatë janë lënë në mëshirën e fatit. Pozita e tyre ka qenë juridikisht e parregulluar. Si rezultat i ushtrimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve, që po rritet kohëve të fundit, në pjesën dërrmuese të vendeve të botës pozita e fëmijëve jashtëmartesorë tani është përmirësuar dukshëm.

Fëmijës nuk i lejohet e drejta e punës, pa e arritur moshën përkatëse minimale, në asnjë mënyrë nuk i jepet shkas apo nuk i lejohet të ushtrojë një profesion apo veprimtari që çënon shëndetin apo edukimin e tij, apo që pengon në zhvillimin e tij shoqëror, shpirtëror dhe fizik (neni 9 i Parimeve të Deklaratës mbi të drejtat e fëmijës, 1959).

Në të drejtën tonë fëmijët jashtëmartesorë janë barazuar plotësisht me fëmijët martesorë, si në pikëpamje të të drejtave ashtu edhe të detyrimeve. Fëmijë jashtëmartesorë quajmë:

- Çdo fëmijë jashtëmartesor që e ka lindur gruaja e pamartuar,
- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e ve, dmth. gruaja e martuar pas zgjidhjes së martesës dhe pas kalimit të afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës,
- Çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e martuar gjatë martesës apo shpalljes së saj të pavlefshme, ose atësia e fëmijës është kundërshtuar gjyqësisht me aktgjykim të formës së prerë, ose brenda afatit prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës.

Është e domosdoshme të vërtetohen prindërit, që barazia e fëmijëve të realizohet<sup>27</sup>. Vërtetimi i marrëdhënieve prindërore jashtëmartesore bëhet në këto mënyra: a) me njohjen e amësisë, b) me njohjen e atësisë dhe c) me njohjen e atësisë dhe të amësisë me vendim gjyqësor.

- a) Njohja e amësisë - është një veprim i njëanshëm juridik i një gruaje, e cila shpreh vullnetin e lirë ligjërishit se ajo është nëna e fëmijës të lindur jashtëmartesor. Njohja e amësisë paraqitet rrallë në praktikë si dukuri, sepse nëna shumë vështirë vendos ta braktisë fëmijën e vet. Për këtë arsye shumë vende të botës nuk e kanë rregulluar me dispozita konkrete ligjore çështjen e njohjes së amësisë, ky problem i njohjes së amësisë nuk është i rregulluar as me dispozitat e LFK-së.
- b) Njohja e atësisë - sikurse njohja e amësisë, edhe njohja e atësisë është një akt i njëanshëm juridik me anë të të cilit mashkulli shpreh në mënyrë valide vullnetin e vet se ai është i ati i fëmijës jashtëmartesor. Për dallim prej njohjes së amësisë e cila është e rregulluar shumë pak me ligje, njohja e atësisë është e rregulluar me dispozita ligjore pothuajse në shumicën e vendeve të botës. Atësia mund ti njihet mashkullit i cili ka aftësi të veprimit dhe i cili ka arritur moshën 16-vjeçare, si dhe personit i cili pjesërisht ka qenë i zhveshur nga zotësia për të vepruar, nëse është në gjendje të kuptojë përmbajtjen e deklaratës për njohjen e atësisë (neni 102 i LFK-së). Atë i fëmijës së lindur jashtë martese është personi madhor që e njuh fëmijën për të vetin. Dallimi midis legjislacionit të Kosovës dhe atij të Shqipërisë është se legjislacioni i Kosovës ia njuh të drejtën për njohjen e atësisë edhe mashkullit të mitur i cili ka mbushur moshën 16 vjeçare.

---

<sup>27</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 247

Mashkulli i cili dëshiron ta njoh fëmijën jashtëmartesor për të vetin, duhet të bëjë deklarin e vullnetit personalisht. Deklarata për njohjen e atësisë nuk mund të jepet përmes përfaqësuesit me prokurë (neni 103 par. 4 i LFK-së). Njohja është gjithashtu akt individual dhe moral sepse përcakton atësinë e fëmijës të lindur jashtëmartesor. Njohja e atësisë duhet të bëhet veç e veç për çdo fëmijë. Kjo do të thotë se njohja nuk është e lejueshme të bëhet me një deklaratë dhe njëkohësisht për shumë fëmijë

**Procedura për njohjen e atësisë** – procedura është mjaft e thejshtë, personi i cili veten e konsideron atë të fëmijës mund ta pranojë atësinë në njërin nga këto mënyra:

- Duke deklaruar në procesverbal para ofiqarit se e njeh atësinë e fëmijës jashtëmartesor,
- Duke deklaruar se e njeh atësinë e fëmijës jashtëmartesor para organit të kujdestarisë,
- Me testament

Njohja e atësisë në këto mënyra është paraparë me dispozitën e nenit 103 të LFK-së. Sipas nenit 51 të LFM-së njohja e atësisë përveç përpara ofiqarit, qendrës për punë sociale mund të bëhet edhe përpara gjyqit.

**Kushtet për njohjen e atësisë** – janë të rregulluara me dispozita ligjore<sup>28</sup>. Megjithatë ka rëndësi të theksohet se kur është fjala për njohjen e atësisë nuk vërtetohet nëse mashkulli i cili e pranon fëmijën për të vetin është edhe atë natyror i fëmijës<sup>29</sup>. Ligji i familjes i Kosovës ka paraparë këto kushte për njohjen e plotëfuqishme të fëmijës:

- a) lindja gjallë e fëmijës,
- b) pëlqimi i nënës së fëmijës,
- c) pëlqimi i fëmijës dhe
- ç) zotësia për të vepruar.

**Efektet juridike të njohjes së atësisë** – edhe me njohjen e atësisë shkaktohen ato efekte juridike sikurse me vërtetimin e atësisë. Me rastin e vërtetimit të atësisë vendosen marrëdhëniet prindërore mes atit dhe fëmijës jashtëmartesor të cilat në të vërtetë kanë ekzistuar nga lindja e fëmijës. Poashtu krijohen edhe marrëdhëniet juridike mes fëmijës jashtëmartesor dhe gjinisë së atit, atësia e të cilit është vërtetuar me njohjen e atësisë. Njohja e atësisë regjistrohet në regjistrat amë të të lindurve.

**Anulimi i atësisë së njohur** – mund të bëhet në qoftë se me rastin e njohjes së fëmijës jashtëmartesor nuk kanë qenë të plotësuara kushtet ligjore. Duke marrë për bazë kushtet ligjore të detyrueshme për njohjen e atësisë së plotëfuqishme mund të thuhet se anulimi i atësisë mund të jetë absolut dhe relativ.

**Kundërshtimi i atësisë së njohur** – me njohjen e atësisë vërtetohet atësia dhe vendosen marrëdhëniet prindërore midis atit dhe fëmijës<sup>30</sup>. Padia për kundërshtimin e atësisë mund të paraqitet nga personi i cili veten e konsideron atë natyror të fëmijës. E drejta e padisë parashkruhet me kalimin e një viti nga regjistrimi i atësisë në regjistrin e gjendjes civile (neni 188, par. 3 i KFSH-së).

---

<sup>28</sup>Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.207

<sup>29</sup>Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.208

<sup>30</sup>Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.209

## 2. Vërtetimi i amësisë me vendim të Gjykatës

Me vërtetimin e amësisë me vendim gjyqësor gjithashtu vendosen marrëdhëniet prindërore midis nënës dhe fëmijës jashtë martese, me vendim të gjyqit. Edhe pse shtatëzania dhe lindja e fëmijës, janë ngjarje të dukshme, ndërsa nëna vështirë vendos ta braktis fëmijën e vet, ngase ka ndjenja të



fuqishme emocionale të fuqishme, prapëseprapë, në teorinë juridike sundon mendimi se vërtetimi i amësisë me vendim gjyqësor është i arsyeshëm.

Arsyeshmëria qëndron në faktin se në shërbimet e maternitetit ndodhin raste të ndërrimit të foshnjave, qoftë me dashje apo në mënyrë të pavullnetshme. Si pasojë, lind konflikti rreth të drejtës së amësisë mes nënës natyrore e cila ka lindur fëmijën, dhe një gruaje tjetër e cila pretendon se fëmija është i saj.

Dukuria e trafikimit të fëmijëve duke i shëndërruar ata në objekt tregtie, po zmadhohet e cila është në kundërshtim me nenin 9 të parimeve të Deklaratës për të drejtat e fëmijës (1959).

Janë të njohura rastet e simulimit të lindjeve dhe të shitblerjes së fëmijëve të huaj qysh në lindjen e tyre<sup>31</sup>.

Do theksuar se, me gjithë rëndësinë që merr e drejta e vërtetimit të amësisë me vendim gjyqësor, prapëseprapë procedura e vërtetimit të amësisë nuk është e rregulluar me norma ligjore të Ligjit për familjen të Kosovës. Gjykata në mungesë të normave ligjore, të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e amësisë zbaton në mënyrë analoge dispozita ligjore, të cilat kanë të bëjnë me vërtetimin e atësisë me vendim të gjyqit.

Shumë më e thjeshtë dhe shumë më e shpejtë është procedura e njohjes së amësisë, sesa ajo e vërtetimit të amësisë me vendim të gjykatës. Si kriter bazë për vërtetimin e amësisë gjykata merr parasysh shtatëzaninë dhe lindjen e fëmijës, si ngjarje të dukshme, duke qenë se nënë e fëmijës konsiderohet gruaje e cila e ka lindur fëmijën.

E rëndësishme është se me vërtetimin e amësisë me vendim të gjykatës vendosen marrëdhëniet prindërore mes nënës dhe fëmijës, sikurse edhe marrëdhëniet juridike të fëmijës me gjininë e nënës.

Theksojmë se fëmija edhe më tutje mban statusin e fëmijës jashtëmartesor, por me këtë rast ai e ndryshon statusin familjar, për aq sa tani amësinë e ka të vërtetuar<sup>32</sup>.

---

<sup>31</sup>Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.209

<sup>32</sup>Dr.Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr.Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.210

### **3. Vërtetimi i atësisë me vendim të Gjykatës**

Fëmija ka të drejtë natyrore të rritet dhe të jetojë me të dy prindërit e vet. Duke marrë përparësi mbrojtjen e interesave të fëmijëve, e drejta moderne lejon vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës në të gjitha rastet duke synuar ndalimin e çfarëdo forme të diskriminimit të fëmijëve

jashtë martesë dhe barazimin e tyre në pikëpamje të të drejtave dhe detyrimeve me fëmijët martesorë.

Me dispozitën e nenit 189 KFSH-ja vërtetimin e atësisë së fëmijës së lindur jashtë martesë e rregullon shprehimisht.

Atësia e një fëmije të lindur jashtë martesë mund të vërtetohet me vendim të gjykatës, në rast se gjatë gjykimit provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë se nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martesë, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të vetin (neni 189 i KFSH-së). Në teorinë juridike mbizotëron mendimi se vërtetimi i atësisë së fëmijës të lindur jashtë martesë me vendim të gjykatës mund të bëhet vetëm pasi të ketë lindur fëmija.

**E drejta e paraqitjes së padisë-** E drejta e paraqitjes së padisë për vërtetimin e atësisë së fëmijës të lindur jashtë martesë me vendim të gjykatës u njihet këtyre subjekteve: nënës së fëmijës, fëmijës, personit i cili pretendon se është ati i fëmijës por ka qenë i penguar për njohjen e atësisë dhe organit të kujdestarisë.

E drejta e paraqitjes së padisë për vërtetimin e atësisë të një fëmije të lindur në marrëdhëniet jashtëmartesore i njihet nënës së fëmijës<sup>33</sup>, gjithmonë derisa ajo ushtron të drejtën prindërore.

Ajo, si subjekt i së drejtës prindërore, këtë të drejtë e ushtron në mënyrë të pavarur. Nëna e fëmijës mund të paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë në emër të vet dhe në emër të fëmijës, ose njëkohësisht edhe në emër të vet po edhe në emër të fëmijës, si përfaqësues ligjor i fëmijës<sup>34</sup>. Kur nëna ka vdekur ose nuk e ushtron më të drejtën prindërore, sepse ajo i është hequr apo për çfarëdo shkakut tjetër është në pamundësi që ta ushtojë atë, e drejta e paraqitjes së padisë i kalon kujdestarit. Kujdestari, sipas dispozitës së nenit 110 par. 3 të LFK-së, padinë mund ta paraqesë vetëm me lejen e organit të kujdestarisë.

Organi i kujdestarisë mund ta paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës në qoftë se nëna e fëmijës, me rastin e paraqitjes së lindjes së fëmijës ka shënuar emrin e personit të cilin ajo e konsideron atë të fëmijës dhe nuk ka ushtruar padinë për vërtetimin e atësisë, duke lënë pas dore mbrojtjen e interesave të fëmijëve.

Konsiderohet se nëna ka lënë pas dore mbrojtjen e interesave të fëmijëve nëse ka kaluar afati ligjor e ajo nuk e ka paraqitur padinë në gjyq.

---

<sup>33</sup>Santhipi Begeja, vepër e cituar, faqe 168

<sup>34</sup>Dr. Nerimana Traljac, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 128

Vetëm pas kalimit të afatit, organi i kujdestarisë ka të drejtë të paraqesë padinë në gjyq për vërtetimin e atësisë së fëmijës të lindur jashtë martesë me vendim të gjykatës.

Po ashtu, fëmija ka të drejtë të paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës. Derisa fëmija është i mitur apo nuk ka zotësinë për të vepruar, padinë në emër të tij mund ta

paraqesë nëna, si përfaqësuese ligjore e fëmijës<sup>35</sup>, apo në kushte të caktuara si më lartë, padinë mund ta paraqesë edhe kujdestari.

Edhe personi i cili veten e konsideron atë të fëmijës ka të drejtë të paraqesë padinë për vërtetimin e atësisë me vendim të gjykatës. Personit, i cili konsideron të jetë atë i fëmijës, rregullativa ligjore ia njeh të drejtën e padisë vetëm në rastet kur i është pamundësuar njohja e atësisë jashtë martese, e jo edhe atëherë kur ai ka qenë i gatshëm për ta pranuar fëmijën për të vetin, por ka dëshiruar që në procedurë gjyqësore duke marrë të gjitha provat e nevojshme materiale, të vërtetojë se ai është në të vërtetë ati i fëmijës<sup>36</sup>.

**Efektet e vërtetimit të atësisë jashtëmartesore-** Si në rastin e njohjes së atësisë, ashtu edhe kur është fjala për vërtetimin e atësisë së fëmijës të lindur jashtë martese, kemi të bëjmë me vendosjen e marrëdhënieve prindërore mes fëmijës jashtëmartesor dhe të atit, të cilit atësia i është vërtetuar me vendim të gjykatës.

Pra, edhe me këtë rast krijohen marrëdhëniet juridike mes fëmijës jashtëmartesor me gjininë e atit të vërtetuar me vendim të gjyqit.

Fëmija vendoset në familjen e atit të vërtetuar. Ai ka të drejtë ta lërë mbiemrin e nënës, të cilën e mbante deri atëherë, dhe ta marrë mbiemrin e të atit.

Statusi i fëmijës nuk ndryshon- statusin jashtëmartor të cilin fëmija e kishte fituar me lindje, do ta mbajë edhe më tutje<sup>37</sup>.

Aktgjykimi mbi vërtetimin e atësisë së fëmijës jashtëmartesor ka efekte absolute, ai vepron ndaj të gjithëve "erga omnes", dhe të gjithë kanë detyrë ta respektojnë<sup>38</sup>.

---

<sup>35</sup>Dr. Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr. Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq.212

<sup>36</sup>Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 128

<sup>37</sup>Dr. Nerimana Traljic, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 132

<sup>38</sup>Po aty, faqe 132

#### **4. Kuptimi i së drejtës prindërore**

Të drejtën prindërore e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore.

E drejta prindërore është pjesë përbërëse e së drejtës familjare, ajo merret me studimin e marrëdhënieve midis prindërve dhe fëmijëve dhe të marrëdhënieve midis personave të tjerë në gjini.

E drejta prindërore është tërësi rregullash juridike me të cilat rregullohen marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve, midis birësuesit dhe të birësuarit, midis kushërinjëve dhe ndaj personave të tjerë në gjini.

E drejta prindërore u takon në masë të njejtë edhe nënës edhe babait. Nëse njëri nga prindërit është i vdekur ose nuk është i njohur ose i është marur e drejta prindërore ose për shkaqe të tjera është penguar që të ushtrojë të drejtën prindërore, atëherë të drejtën prindërore e ushtron prindi tjetër.

E drejta prindërore është pjesë përbërëse e sistemit juridik të vendit. Marrëdhënia prindërore përmban dy elemente kryesore: elementin natyral dhe elementin juridik (të përgjithshëm)<sup>39</sup>.

Elementi natyral biologjik është konstant, gjithmonë i pandryshuar dhe manifestohet me lindje. Marrëdhëniet prindërore zgjasin deri në mbushjen e moshës madhore të fëmijës. Vetëm në rastet e parapara me ligj ato mund të vazhdojnë edhe pas mbushjes së moshës madhore.

Mund të konkludojmë se jo të gjitha marrëdhëniet prindërore mbarojnë mes prindërve dhe fëmijëve, kur këta të fundit e fitojnë moshën madhore.

Elementi juridik, përkatësisht komponentja e përgjithshme imponon nevojën e vërtetimit të lidhjes biologjike të fëmijës me prindërit veç e veç<sup>40</sup>.

Posaçërisht kjo gjen shprehje në rastin e vërtetimit të atësisë ose amësisë. Rregullat juridike me të cilat rregullohen këto marrëdhënie janë të përfshira në Ligjin për familjen.

Është e kuptueshme se fëmija lind në familje dhe marrëdhëniet e prindërve dhe të fëmijëve krijohen në momentin e lindjes së tyre, ndonëse në doktrinën juridike ka mendime se këto marrëdhënie krijohen edhe më herët, madje me vetë zënieën e fëmijës.

---

<sup>39</sup>Lilana Cpirovik-Terpenovska, vepër e cituar, faqe 146

<sup>40</sup>Po aty, faqe 146

## **5. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve**

Të drejtat dhe detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve të mitur janë të dylojshme:

- a) Të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve
- b) Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj pronës së fëmijëve.

**Të drejtat dhe detyrat personale të prindërve ndaj fëmijëve-** të drejtat prindërore janë të lidhura ngushtë me personalitetin e prindit. Askush nuk ka të drejtë të përzihet në marrëdhëniet mes fëmijëve dhe prindërve, përderisa prindërit të drejtat dhe detyrimet i ushtrojnë në interes të fëmijëve.

Mund të thuhet se e drejta prindërore njëkohësisht është edhe e drejtë absolute e prindërve. Ata kanë të drejtë të kërkojnë nga organet shtetërore të merren masa ndaj çdo personi që ata i pengon në ushtrimin e të drejtave prindërore.

Këto të drejta nuk mund t'i kalojnë një personi tjetër e as të trashëgohen<sup>41</sup>. Prindërit i ushtrojnë të drejtat prindërore me marrëveshje.

Në ushtrimin e tyre janë plotësisht të barabartë, dmth. kanë të drejta, detyra dhe përgjegjësi të njëjta. Prindërit kanë të drejtë dhe obligim që t'i ushqejnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, t'i përgatisin për jetë dhe punë të pavarur, të kujdesen për edukimin e tyre, shkollimin dhe aftësimin profesional.

Fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre. Prindi me të cilin nuk jeton fëmiju, ka të drejtë në mbajtjen e lidhjeve personale me fëmijën e vet. Prindërit poashtu kanë të drejtë dhe janë të obliguar t'i përfaqësojnë fëmijët e tyre.

Të drejtat dhe detyrat prindërore nuk janë të përhershme. Ato mbarojnë kur fëmija mbush moshën madhore, kur bëhet i aftë të kujdeset për vete, për të drejtat dhe interesat e veta.

Të drejtat dhe detyrat e prindërve ndaj fëmijëve janë:

1. Caktimi i emrit,
2. Ruajtja dhe mirërritja,
3. Arsimimi dhe edukimi,
4. Mbajtja,
5. Përfaqësimi.

**Caktimi i emrit-** emri personal përbëhet nga emri dhe mbiemri<sup>42</sup>. Çdo fëmijë i lindur ka të drejtë të ketë emrin personal. Me marrëveshje prindërit i zgjedhin dhe i caktojnë fëmijës emrin personal. Në qoftë se nuk arrihet marrëveshja, atëherë fëmijës i zgjedh dhe i cakton emrin organi i kujdestarisë, pasi të ketë dëgjuar të dy prindërit lidhur me këtë çështje.

Fëmijës së gjetur, kur nuk i dihen prindërit, gjithmonë emrin i cakton organi i kujdestarisë.

Ashtu sikurse me rastin e caktimit të emrit edhe mbiemrin e caktojnë të dy prindërit me marrëveshje. Në qoftë se ndodh që prindërit të kenë mbiemra të ndryshëm, fëmija merr mbiemrin e njërit apo të të dy prindërve.

---

<sup>41</sup> Santhipi Begeja: vepër e cituar, faqe 205

<sup>42</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 297

Kur prindërit nuk mund të arrijnë marrëveshje lidhur me caktimin e mbiemrit, gjithashtu edhe mbiemrin e cakton organi i kujdestarisë, pasi të ketë dëgjuar të dy prindërit. Sipas nenit 171 Të KFSH-së, fëmija i lindur jashtë martesës e merr mbiemrin e prindërit, amësia ose atësia e të cilit është vendosur më parë.

Sipas kësaj dispozite nëse amësia dhe atësia vendosen në të njëjtën kohë, prindërit vendosin me marrëveshje se cilin mbiemër do ta mbajë fëmija. Në rast mosmarrëveshjeje, fëmija merr mbiemrin e të atit.

Pas ndryshimeve statusore të familjes, fëmijës së mitur mund t'i caktohet mbiemri i ri. Sipas dispozitës së nenit 132 të LFK-së, mund të lejohet caktimi i mbiemrit të ri brenda afatit prej dy muajsh, pas ndryshimeve statusore të familjes. Pëlqimi i fëmijës është i nevojshëm, nëse fëmija është mbi moshën dhjetë vjeçare (neni 132 par. 2 i LFK –së).

**Ruajtja dhe mirërritja e fëmijëve-** Prindërit kanë për detyrë që bashkërisht të përkujdesen për jetën dhe shëndetin e fëmijëve<sup>43</sup>. Kjo nënkupton se detyrë e prindërve është që fëmijët e tyre të mitur t'i mbrojnë prej çfarëdo rreziku që atyre u kanoset.

Në rast të sëmundjes apo dëmtimit të shëndetit, prindërit kanë për detyrë përkujdesjen për shërimin e fëmijëve të mitur, duke u siguruar ayre shërbimet e nevojshme mjekësore në institucione të specializuara shëndetësore.

Ata poashtu kanë të drejtë të zgjedhin mjekun dhe institucionin shëndetësor në të cilin fëmija do të shërohet<sup>44</sup>.

Të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh a kanë lindur brenda bashkësisë martesore apo jashtë saj, gëzojnë mbrojtje të njëjtë sociale dhe shëndetësore<sup>45</sup>.

Prindërit kanë detyrë që fëmijën ta mbrojnë nga gabimet, të cilat mund të vijnë si pasojë e moshës së re të tij.

Sipas nenit 125 të LFK-së, fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje me prindër, ndërsa ata që nuk jetojnë bashkë me të dy prindërit kanë të drejtë ta takojnë rregullisht prindin me të cilin nuk jetojnë së bashku.

Prindërit e kryejnë më mirë detyrimin e ruajtjes dhe të mirërritjes së fëmijëve kur i kanë në familje, pranë vetës. Megjithatë, këtë detyrë ata mund t'ia besojnë edhe një institucioni ose një personi të tretë<sup>46</sup>.

Fëmijët me zhvillim të metë mental apo fizik kanë të drejtë në kujdes të posaçëm, që t'u sigurohet jetë e dinjitetshme dhe pjesëmarrje aktive në aktivitete shoqërore (neni 125 par.3 i LFK-së). Prindërit kanë të drejtë të kërkojnë kthimin e fëmijëve të cilët mbahen në mënyrë të paligjshme nga një person tjetër.

---

<sup>43</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 297

<sup>44</sup>Dr. Marina Janjic – Komar dr. Radoje Korac dr. Zoran Ponjavic: vepra e cituar, fq. 225

<sup>45</sup>Asbjern Eide dhe Wenche Barth Eide, Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut, botuar në Holandë, faqe 552

<sup>46</sup>Santhipi Begeja: vepër e cituar, faqe 210

Arsimimi është mbrojtës më i miri i lirisë sesa një armatë e tërë. Shih: ‘Kuptimi i të drejtave të njeriut’, Human Security Network, Grac, Austria 2003, faqe 211

**Arsimimi dhe edukimi-** Çdo fëmijë ka të drejtë në arsimim dhe edukim. Prindërit kanë për detyrë që të kujdesen për arsimim dhe edukim të drejtë të fëmijëve të mitur, ashtu që ata të përvetësojnë nga sistemi i vlerave pozitive të shoqërisë.

Prindërit kanë të drejtën prindërore që të zgjedhin llojin e shkollimit, i cili do t'u ofrohet fëmijëve<sup>47</sup>, duke marrë parasysh aftësitë, prirjet dhe dëshirat e tyre.

Përveç prindërve dhe familjes, në edukimin dhe arsimimin e shëndoshë të brezit të ri marrin pjesë edhe institucione të ndryshme shoqërore dhe shtetërore, duke filluar prej atyre parashkollore e deri te ato shkollore, organi i kujdestarisë, shërbimet profesionale, pedagogjike etj.

Kur fëmijët kanë sjellje të këqija, mund të njoftohet organi i kujdestarisë, i cili ka për detyrë të ndërmarrë masa të nevojshme dhe të intervenojë për mënjanimin e mangësive në edukimin e fëmijëve<sup>48</sup>.

**E drejta e mbajtjes-** Çdo fëmijë ka të drejtë në mbajtje nga prindërit e vet. Me mbajtje duhet kuptuar të gjitha shpenzimet e nevojshme për ushqim, veshmbathje, banim, edukim, shkollim dhe shërim të fëmijëve<sup>49</sup>.

Për plotësimin e këtyre nevojave të fëmijëve, dy prindërit janë të detyruar të sigurojnë të mirat materiale, pavarësisht nga ajo se a janë apo jo duke jetuar së bashku. Lartësinë e shpenzimeve për ushqim dhe mbajtje të fëmijëve gjykata e cakton duke marrë parasysh mundësitë materiale të prindërve dhe nevojat e fëmijëve.

E drejta e fëmijëve për mbajtje mbaron me plotësimin e kushteve ligjore për pushimin e saj: me vdekje ose shpallje të fëmijës të zhdukur për të vdekur apo të prindërve të tij, me arritjen e moshës madhore ose me emancipimin e fëmijës.

Nëse fëmija i moshës madhore nuk është në gjendje të punojë për shkak të sëmundjes, të metave fizike dhe mentale dhe ai nuk ka sasi të mjaftueshme të mjeteve financiare për shpenzimet e tij financiare, prindërit kanë për detyrim të sigurojnë ndihmën financiare derisa një situatë e tillë të mbarojë (neni 294 i LFK-së).

**Përfaqësimi-** Dy prindërit janë të autorizuar ligjorë për përfaqësimin e fëmijëve të tyre të përbashkët në të gjitha veprimet juridike. Për shkak se autorizimet e prindërve për përfaqësimin e fëmijëve burojnë nga vetë ligji, prindërit quhen përfaqësues ligjorë.

Theksojmë se fëmija i mitur deri në moshën 14-vjeçare nuk ka zotësinë për të vepruar. Për këtë, në emër e në llogari të tij veprimet juridike i ndërmerr prindi ose kujdestari.

Të miturit të cilët kanë mbushur moshën 14-vjeçare, disa veprime juridike mund t'i ndërmarrin vetë, por që ato të jenë të plotëfuqishme kërkohet leja e prindërve apo e organit të kujdestarisë.

Prindërit nuk mund të përfaqësojnë fare fëmijët në veprimet juridike të cilat janë të lidhura ngushtë me personalitetin e tij, siç janë p.sh. lidhja e martesës, njohja e atësisë etj<sup>50</sup>.

---

<sup>47</sup>Shih: Neni 26, paragrafi 3 i Deklaratës universale mbi të drejtat e njeriut

<sup>48</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 299

<sup>49</sup>Po aty, faqe 301

<sup>50</sup>Vojislav Bakic: vepër e cituar, fq. 306

## **6. Marrëdhëniet pasurore juridike të prindërve dhe fëmijëve**

### **Marrëdhëniet pasurore martesore**

Përveç të drejtave personale të cilat i posedojnë bashkëshortët me lidhjen e martesës, rëndësi të veçantë kanë edhe të drejtat pasurore apo marrëdhëniet pasurore që lindin midis bashkëshortëve në martesë. Këta marrëdhënie që lindin në jetën martesore rregullohen me dispozita ligjore të cilat i parasheh LF-ja. Kjo tërësi e normave ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet pasurore të çiftit bashkëshortor në doktrinën juridike quhet regjim pasuror martesor. Regjimi pasuror si kategori juridike parashihet në forma të ndryshme në të drejtën komparative. Kështu dallohen : regjimi i pasurisë së veçantë, regjimi i pasurisë së përbashkët dhe regjimi i kombinuar.

**Regjimi i pasurisë së veçantë-** nënkupton normat juridike që rregullojnë çështjen e pasurisë të veçantë nga martesja. Pra, flitet për pasurinë të cilën e ka zotëruar bashkëshorti para lidhjes së martesës dhe në këtë kontekst mund të shtojmë se titullari i kësaj pasurie të veçantë posedon dhe qeveris pronësinë e tij në mënyrë të pavarur nga bashkëshorti, pasi që nuk e ka fituar gjatë jetës martesore të përbashkët.

**Regjimi i pasurisë së përbashkët-** në të njëjtën mënyrë rregullohet me normat juridike të LF-së, por e veçanta e kësaj pasurie në krahasim me pasurinë e veçantë qëndron në faktin se kjo pasuri është fituar me punë të përbashkët midis dy bashkëshortëve në jetën martesore. Në pasurinë e përbashkët të dy bashkëshortët janë titullarë të përbashkët të të drejtës së pronësisë.

**Regjimi i pasurisë të kombinuar-**përfshin elemente të të dy regjimeve paraprake, të pasurisë të veçantë dhe asaj të përbashkët. Duke u nisur nga parimi i barazisë midis bashkëshortëve, synohet realizimi i barabartë i të drejtave të bashkëshortëve lidhur me administrimin dhe disponimin e pronësisë në mënyrë të barabartë. Legjislacionet moderne të disa shteteve parashohin kontratën si punë juridike me të cilën bashkëshortët vetë mund të zgjedhin njërin nga regjimet pasurore martesore. Nëse nuk lidhet kjo kontratë atëherë flasim për regjim ligjor që parashihet edhe në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë. Regjimi ligjor pasuror martesor parashihet në nenin 203 të LF-së të RM-së, sipas të cilit *“Pasuria e çiftit bashkëshortor mund të jetë e veçantë dhe e përbashkët”*<sup>51</sup>.

---

<sup>51</sup>Neni 203 i LF-së të RM-së.



Pasuria të cilën bashkëshortët jashtëmartesorë do ta fitojnë në bashkësinë jashtëmartesore llogaritet si pasuri e tyre e përbashkët. Gjatë ndarjes së asaj pasurie zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat për pjesëtimin (ndarjen) e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve martesorë<sup>52</sup>.

Marrëdhëniet pasurore mund të lindin edhe në bashkësinë jashtëmartesore, pasi që edhe në këtë bashkësi krijohen dhe shpenzohen mjete materiale, fitohet pasuri si dhe themelohen detyrime. Vlen të potencohet se marrëdhëniet që lindin midis bashkëshortëve në bashkësinë jashtëmartesore deri vonë nuk kanë qenë të rregulluara me rregullativë ligjore, me çka ka munguar mbrojtja ligjore e marrëdhënieve pasurore midis këtyre bashkëshortëve.

Me reformimin e të drejtës familjare është rregulluar edhe çështja e bashkësisë jashtëmartesore, sidomos çështjes të ndërsjellë të ushqimit midis këtyre bashkëshortëve si dhe marrëdhënieve pasurore që rrjedhin nga pasuria e përbashkët jashtëmartesore.

Pasuria e krijuar në këtë bashkësi nga të dy bashkëshortët konsiderohet si pasuri e përbashkët. Kjo dispozitë ligjore mundëson që gjykatat t'ju japin mbrojtjen e nevojshme ligjore edhe marrëdhënieve pasurore që rrjedhin nga pasuria e përbashkët e bashkëshortëve jashtëmartesor. Gjatë ndarjes të pasurisë së përbashkët jashtëmartesore vlejnë dispozitat identike me ata të ndarjes së pasurisë në martesën e rregullt.

Në praktikën gjyqësore mbrojtjen ligjore të bashkësisë jashtëmartesore mund ta gëzojë vetëm bashkësia jashtëmartesore e themeluar në mënyrë ligjore, që don të thotë që në momentin e themelimit të saj nuk kanë ekzistuar pengesa dhe ndalesa martesore dhe se kjo bashkësi ka zgjatur një kohë të gjatë.

---

<sup>52</sup>Neni 218 i LF-së së RM-së.

Afatet kohore për zgjatjen e kësaj bashkësie ligji nuk i parasheh, por gjykata do të shfrytëzojë standarde juridike që të vlerësoj specifikat e rastit konkret dhe të vlerësoj se kur është plotësuar ky kusht.

As në teorinë juridike nuk ka definicione të përgjithshme të pranura të nocionit bashkësi jashtëmartesore, pasi që mendohet se nuk ekziston një lloj i veçantë i bashkësisë jetësore.

Martesa është bashkësi jetësore vetëm mes një gruaje dhe një burri. Bashkësia e regjistruar jashtëmartesore, apo cilado formë tjetër e regjistruar e partneritetit jetësor është bashkësi jetësore vetëm mes një gruaje dhe një burri. Këtë e parashikon projekt-amandamenti i ri Kushtetues që Qeveria e parashtrroi deri te Kuvendi.

Gjithashtu me ligjin aktual për familje, bashkësia jashtëmartesore definohet, ajo bashkësi jashtëmartesore e cila zgjat më shumë se një vit me çka barazohet me bashkinë martesore në pikëpamje të financimit të ndërsjellë dhe pronën e fituar në kohëzgjatjen e bashkësisë jashtëmartesore”.

### **Marrëdhëniet pasurore midis prindërve dhe fëmijëve**

Këta marrëdhënie lindin në bashkësinë familjare midis prindërve dhe fëmijëve dhe kanë specifikat e tyre të veçanta që nuk i posedojnë marrëdhëniet tjera pronësore brenda familjes.

Neni 219 i LF të RM-së parasheh: *”Fëmijët minorenë mund të kenë pasurinë e tyre të cilën do ta fitojnë sipas ligjit dhe në bazë ligjore. Me këtë pasuri, përveç që i mituri e ka fituar me punën e tij, deri në arritjen e moshës madhore me këtë pasuri do të administrojnë dhe do të disponojnë prindërit e tij”*. Mëtej neni 220 parasheh: *“Nëse prindërit nuk jetojnë bashkërisht, me pasurinë e fëmijës do të administrojë prindi me të cilin jeton fëmija, nëse Qendra për Punë Sociale me propozim të prindit tjetër, nuk ka vendosur ndryshe”*<sup>53</sup>.

Të gjithë të hyrat që burojnë nga pasuria e të miturit, prindërit mund t’i përdorin fillimisht për mirëmbajtjen e fëmijës, edukimin dhe shkollimin e tij, si dhe nevojat e domosdoshme për bashkësinë familjare, nëse prindërit nuk disponojnë me mjete financiare dhe pasuri të tyre. Dhe së fundi, Ligji parasheh që prindërit me pajtueshmëri të Qendrës për Punë Sociale mund ta huazojnë apo ngarkojnë me veprime juridike pasurinë e fëmijës së tyre për shkak të mirëmbajtjes së tij, edukimit dhe shkollimit si dhe këtë nëse e kërkojnë interesat tjera të cilat janë të nevojshme për bashkësinë familjare. Kjo dmth. se ata nuk kanë liri absolute për sa i përket administrimit të pasurisë së fëmijëve të tyre të mitur.

**E drejta e administrimit të pasurisë së fëmijëve të mitur-** pasurinë e fëmijës deri në moshën madhore të tij e administrojnë prindërit në dobi të fëmijës (neni 134 i LFK-së), që nënkupton se titullari i së drejtë mbi pasurinë e fëmijës së mitur është vetë fëmija.

Fëmijët e mitur që kanë mbushur moshën 15 – vjeçare, me pëlqimin e prindërve mund të themelojnë marrëdhënie pune. Të ardhurat e realizuara me punën e vet ata mund t’i disponojnë e t’i administrojnë vetë në mënyrë të pavarur.

**E drejta e pronësisë-** Në praktikë janë të rallë rastet kur një fëmijë të ketë pasurinë e vet. Nuk ka dyshim se fëmijët gëzojnë të drejtën e pronësisë mbi pronën e tyre të veçantë edhe kur prindërit, sipas dispozitave ligjore janë të autorizuar ta administrojnë atë. Kjo pasuri nuk hyn në pasurinë e prindërve<sup>54</sup>, sepse është e ndarë nga pasuria e tyre.

---

<sup>53</sup>Neni 219 dhe 220 i LF-së së RM-së.

<sup>54</sup> Santhipi Begeja: vepër e cituar, faqe 217

## **7. Të drejtat dhe detyrat e fëmijëve**

Detyrimet e prindërve janë në raport korelativ me të drejtat e fëmijëve, secili detyrim i prindërve në të njëjtën kohë është edhe e drejtë e fëmijëve<sup>55</sup>. Nga kjo rrjedh se prindërit janë të detyruar të kujdesen për ruajtjen dhe mirërritjen, emrin personal, edukimin dhe shkollimin, administrimin e

pasurisë, përfaqësimin, kurse fëmijët kanë të drejtë të kërkojnë prej prindërve realizimin e këtyre të drejtave.

Është e qartë se edhe fëmijët kanë detyra ndaj prindërve të cilat janë dy llojesh:

- a) **Detyrat ligjore** – fëmijët kanë detyra themelore ligjore që të kujdesen dhe t'i ndihmojnë prindërit e tyre, sidomos kur ata janë të pa aftë për punë dhe nuk kanë mjete të mjaftueshme për jetesë, kur janë të sëmurë ose për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore ose materiale nuk mund të kujdesen për vete dhe të sigurojnë mirëqenie sociale.

Fëmijët madhorë e kanë për detyrë të përkujdesen për prindërit, gjithashtu edhe fëmijët e mitur e kanë për detyrë që të përkujdesen për prindërit.

Nga mosha 15 – vjeçare e tutje, fëmija i cili fiton të ardhura me punën e tij është i detyruar që financiarisht të kontribuojë për mbajtjen e tij dhe nëse është e nevojshme edhe për kontribut të arsyeshëm për mbajtjen e familjes me të cilën jeton.

Fëmijët kanë detyrim t'i mbajnë financiarisht prindërit e tyre, nëse ata nuk janë të aftë për punë dhe nuk kanë të ardhura minimale për të jetuar (neni 297 par. 1 i LFK-së).

Gjykata mund ta lirojë fëmijën nga përmbushja e këtij detyrimi ligjor nëse konstaton se përkundër mundësive financiare, prindi nuk i ka ofruar mbajtje financiare fëmijës, ngase kjo do të paraqiste një padrejtësi të hapur ndaj fëmijës.

Që mbi fëmijët e mitur të rëndojë kjo detyrë, duhet të plotësohen dy kushte:

- Që fëmija të ketë mbushur 15 vjet dhe të realizojë të ardhura me punë personale,
- Që i mituri të ketë pasuri dhe të ardhura nga pasuria.

Mungesa e pasurisë dhe të ardhurave nuk e liron fëmijën e mitur nga detyrat ndaj prindërve, për shkak se ai ka për detyrë që t'i inkurajojë prindërit dhe t'i përkrahë ata duke i vizituar p.sh. në qendra spitalore edhe në qoftë se nuk ka mjete materiale.

- b) **Detyrat morale** – pjesa dërrmuese e detyrimeve që kanë fëmijët ndaj prindërve kanë karakter moral dhe rregullohen në bazë të rregullave të moralit<sup>56</sup>.

Respektimi i prindërve është element pozitiv dhe një detyrë themelore për secilin fëmijë. Kanë detyrë që të sillen në mënyrë korrekte ndaj prindërve si fëmijët martesorë ashtu edhe fëmijët e lindur jashtë martese. Mirësjellja ndaj prindërve është detyrë e të gjithë fëmijëve.

---

<sup>55</sup>Dr. Nerimana Traljac, dr. Suzana Bubic: vepër e cituar faqe 201

<sup>56</sup>Santhipi Begeja: vepër e cituar, faqe 225

#### KAPITULLI IV

### SHQYRTIME KRAHASUESE TË MATERIES SIPAS LEGJISLACIONIT VENDAS DHE LEGJISLACIONEVE TË HUAJA

## 1. Bashkëshorti jashtëmartesor sipas Legjislacioneve të huaja

Neni 11.2 (fjalja e parë sipas së drejtës zakonore ) bashkëshortin jashtëmartesor e parasheh si të barabartë me bashkëshortin martesor sa i përket të drejtave të trashëgimisë. Kjo është vetëm pjesërisht e vërtetë. Neni 11.2 duhet të koordinohet me nenin 28: Barazia e paraparë mes bashkëshortit martesor dhe atij jashtëmartesorë nuk është plotësuar sipas nenit 28.1 i cili thotë se bashkëshortët jashtëmartesorë trashëgojnë nga njëri tjetri vetëm sipas rrethanave të caktuara. Dhe sipas nenit 28.2 kjo qartësohet pasi që ata që bashkëjetojnë nuk është e domosdoshme që të trashëgojnë nga njëri tjetri. Në këtë mënyrë, neni 11.2 duhet të plotësohet ashtu që bashkëshorti jashtëmartesor të jetë i barabartë me bashkëshortin martesor “përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj”.Fjalja e dytë e nenit 11.2 përcakton partneritetin jashtëmartesor si “bashkësi jashtëmartesore” mes çiftit të pamartuar. Ky përkufizim në thelb është në përputhje me nenin 39.1 të Ligjit për familjen, që e klasifikon marrëdhënien jashtëmartesore si “marrëdhënie faktike” mes çiftit që jeton së bashku në stabilitet dhe vazhdimësi. Koncepti i njëjtë është përforcuar më qartë sipas nenit 40, sipas të cilit ata konsiderohen që jetojnë në marrëdhënie faktike (marrëdhënie jashtëmartesore) nëse ata “bashkëjetojnë botërisht si çift.

Prapëseprapë është e paqartë pse neni 58 i Ligjit për familjen, deri sa shqyrton “Marrëdhëniet pronësore të bashkëshortëve jashtëmartesorë”, i referohet paragrafit 1 të bashkësisë jashtëmartesore si “partneritet pa bashkëjetesë”, derisa paragrafi 2 i nenit të njëjtë i referohet situatës faktike si marrëdhënie jashtëmartesore (që duket se ta përkujton konceptin e bashkëjetesës që nxirret dhe i referohet neneve 39 dhe 40)<sup>57</sup>. Kjo mospërputhje mund të shpjegohet me faktin se dy paragrafët e nenit 58 mund t’ireferohen dy situatave të ndryshme: (a) rasti tipik kur bashkëshortët jashtëmartesorë bashkëjetojnë (skenari i “paragrafit 2”) dhe (b) një situatë e pazakontë ku bashkëshortët jashtëmartesorë nuk bashkëjetojnë (skenari i “paragrafit 1”). Nëse është kështu, atëherë shtrohet pyetja pse neni 39, i cili përmban përkufizimin e “Marrëdhënies faktike (marrëdhënies jashtëmartesore)” nuk parasheh skenarin e “paragrafit 1”

---

<sup>57</sup>Prof. Asst. Dr. Jorida Xhafaj dhe Anton N. Prishtinë, Mars 2017, Të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave vetëm bashkëjetesës stabile dhe të vazhdueshme. Gjithashtu është e mundur që referenca nënenin 58.1 për “partneritet pa bashkëjetesë” mund të jetë gabim shtypi legjislativ, por as kjo nuk

shpjegon pse ekzistojnë dy paragrafë të ndryshëm e as nuk e arsyeton përsëritjen në dy paragrafët që pasuria e fituar nga partnerët jashtëmartesorë të konsiderohet pasuri e përbashkët.

Pa marrë parasysh shpjegimin, mungesa e bashkërendimit mes nenit 39 dhe 58 të Ligjit për familjen duhet adresuar qartë. Mendimi ynë se skenari i “paragrafit“ d.m.th. bashkëshortët nuk bashkëjetojnë, duhet larguar nga neni 58 i Ligjit për familjen. Vetëm nëse çifti që jeton së bashku duhet të konsiderohet se kanë marrëdhënie aq të afërta sa për të arsyetuar që pasuria e tyre mund të konsiderohet si e përbashkët. Kjo gjithashtu ka kuptim sipas Ligjit për trashëgiminë, pasi që neni 28 parasheh se vetëm bashkëshortët jashtëmartesor që bashkëjetojnë mund të trashëgojnë në kushte të caktuara të trashëgojnë nga njëri tjetri.

Ekzistojnë edhe disa çështje tjera që ndikojnë në formulimin e nenit 11.2 (fjalë e dytë) e cila kërkon një vëmendje të veçantë. Kjo dispozitë thekson se bashkësia jashtëmartesore nënkupton bashkëjetesën mes një femre të pamartuar dhe një mashkulli të pamartuar, e cila ka zgjatur për një kohë të gjatë dhe ka pushuar me vdekjen e trashëgimlënësit, “me kusht që prezumimet për vlefshmërinë e martesës janë plotësuar”. Përveç faktit se nuk ka nevojë që të definohet “bashkësia jashtëmartesore” pasi që “marrëdhënia faktike (marrëdhënia jashtëmartesore)” është veçse e definuar në nenin 39 të Ligjit për familjen, pjesa e fundit e fjalisë duket të mos jetë e hartuar si duhet. Tutje, formulimi i saj duket të jetë i ndarë nga pjesa tjetër. Prandaj, është e këshillueshme që prapë të hartohet krejtësisht dispozita duke theksuar të paktën se bashkëshorti martesor dhe bashkëshorti jashtëmartesor mund të trashëgojnë njëri tjetrin sipas kushteve të parashikuara me ligj (p.sh. neni 28).

## **2. Legjislacionet e vendeve të huaja në mbrojtjen ligjore të bashkësisë jashtëmartesore.**

Nevoja natyrore burrë-grua për afërsinë mes raporteve reciproke realizuar gjatë historikut në format e ndryshme të bashkësive, kurse në drejtësi me shekuj ekziston dhe qëndron dallimi mes kurorës së bashkësisë jashtëmartesore. Karakteristikë e përbashkët e tyre të kenë përmbajtje jetësore të ngjashme pasi në të dy rastet fjala është për bashkësitë në të cilat plotësohen nevojat e ndryshme të personave të rritur të gjinive të ndryshme (psikike, emocionale, ekonomike etj.)

Dallimi mes kurorës dhe bashkësisë jashtëmartesore është natyrë ligjore. Prandaj, në të drejtën e rregullimit shtetëror kurora lidhet dhe ndërpritet në mënyrë dhe me kufizimet ligjore pikërisht ka efekte ligjore. Bashkësia jashtëmartesore bazohet dhe shkurorëzohet në mënyrë joformale, kurse gjendja e rregullimit të efektit juridik të bashkësive të tilla është e ndryshme. Sipas të dhënave të të drejtës romake në kohën e parë të kurorës (matrimonium) nuk ka qenë formal raporti juridik por fakti social.

Statistikat zyrtare të publikimit (kombëtare dhe ndërkombëtare) shpallin të dhëna të ndryshme për kurorat e lidhura, por jo dhe treguesit në numra dhe shtrirje të bashkësive jashtëmartesore.

Vlerësimi për rritje permanente të bashkësive të tilla në disa shtete të Evropës Perëndimore në dekadat e fundit në mënyrë indirekte tregohen statistikat e rënies së shkallës së kurorave të lidhura dhe në të njëjtën kohë për rritjen e numrit të fëmijëve të lindur jashtë kurorës. Dallimi mes disa të dhënave për këtë paraqitje në Kroaci dhe shtetet kufitare tregon se në Republikën e Kroacisë dukshëm bie shkalla e martesave<sup>58</sup>, si dhe lindja e fëmijëve jashtë kurorës po ashtu në rritje permanente, por më i vogël se në vendet Evropiane.

---

<sup>58</sup>Legjislacioni në Republikën e Kroacisë për bashkësitë jashtëmartesore

Në vendet ku statusi juridik i personave që jetojnë në bashkësi jashtëmartesore nuk është i rregulluar me dispozitë, nga praktika gjyqësore varet si zgjidhen kërkesat pronësore dhe kontestet iniciuar nga gruaja ose burri pas ndërprerjes së jetës bashkëshortore ose vdekjes së

njërit nga bashkëshortët. Mungesa e dispozitave ka sjellë që shtrirja e rregullimit kontraktual të efektit pronësor të bashkësive jashtëmartesore sipas modelit të SHBA-ve ku shpesh paraqitet lidhja e marrëveshjeve për jetë të përbashkët (e a.q. living together agreement). Vlerësimi që në shtetet e Evropës rritet numri i bashkësive jashtëmartesore që ka sjellë Këshilli Evropian (1998) me miratimin e Rekomandimeve për vlefshmërinë e marrëveshjes mes personave që jetojnë në bashkësi si çift i pamartuar dhe disponueshmëria e tyre që disa vende nuk e pranojnë pasi që i llogarisin në kundërshtim me politikën shtetërore ose moralin<sup>59</sup>. Qeverive të vendeve anëtare të BE u rekomandon ndërmarrjen e masave që do t'ju sigurojë pranimin e marrëveshjeve me të cilat rregullohen çështjet pronësore qoftë për kohën e mbajtjen e bashkësive jetësore ose pas shkurorëzimit. I njëjti parim duhet zbatuar në pikëpamje të vlefshmërisë së validitetit. Në Rekomandim nuk kërkohet rregullimi i efekteve ligjore të bashkësive jashtëmartesore, mendimi që partnerët bashkëshortorë vetë i rregullojnë raportet e tyre pronësore për zgjatjen e bashkësisë, pas shkurorëzimit dhe në rast vdekje, kurse shteti të mbrojë vullnetin dhe lirinë e personit që vendosin të jetojnë bashkërisht si çift i pamartuar.

Ky fenomen, sidomos zvogëlimi i numrit të kurorave të lidhura në Republikën e Kroacisë, tregojnë në besueshmërinë që numri i bashkësive jashtëmartesore është në rritje.

Interesi i vogël për kurorë tregon disa të dhëna si në vijim :

	Kurora të lidhura në 1000 banorë			Fëmijë jashtëmartesorë në 100 të lindur		
	Kroaci	Austri	Slloveni	Kroaci	Austri	Slloveni
1980.	7,3	6,2	6,5	5,1	17,8	13,1
1990.	5,9	5,9	4,3	7,0	23,6	24,5
2000.	5,0	4,9	3,6	9,0	31,3	37,1

<sup>59</sup>Rekomandimet për çiftet e pamartuara sipas vlerësimit të KE-së, 1998.

Përqindja më e madhe e fëmijëve jashtëmartesor është shënuar në vitin 2000 në Islandë (63,6%), por në literaturë përmendet që pas lindjes së fëmijëve vjen deri te lidhja e kurorave, Statistikë, 1999, Zagreb dhe Statistikë, 2005<sup>60</sup>.



Rekomandimi Numër (88) që e miratoi Këshilli i ministrave të BE, Bashkësitë jashtëmartesore dhe prindërit jashtëmartesorë në Ligjin për familje, Familja jonë sot, Procedura, Zagreb, 1994.

Numri i shteteve evropiane që me rregullore të reja rregullojnë bashkësitë jashtëmartesore mes gruas dhe burrit është në rritje, mes tyre shembuj janë legjislacioni Slloven dhe Suedez (1987).

Tipare janë modeli slloven i rregullimit ku rregullorja për bashkësitë jashtëmartesore është përfshi në Ligjin për familje, ku gruaja dhe burri në bashkësinë e tyre u janë njohur të gjitha efektet e Ligjit për familje sikur të kishin lidhur kurorë, nëse nuk ka pasur pengesa për shkak të cilave mes tyre nuk ka qenë valide.

Në Suedi e drejta e kohabitimit është e rregulluar me ligj të veçantë, është pranuar e drejta e banesës/shtëpisë dhe të mirave të përbashkëta në amvisëri, por jo dhe në mbështetjen reciproke. Në fillim të shekullit 20-21 paraqiten rregullore të reja që njohin më tepër efekte të bashkësive jashtëmartesore e cila bashkësi mbështetet në formalitete të caktuara.

Në lidhje me këto, ka shembuj që në të njëjtat raporte të rregulluara me ligj në bashkësi me persona të gjinive të ndryshme dhe bashkësi homoseksuale.

Bashkësitë e regjistruara më nuk kanë një tipar që dikur ka qenë qenësore për definicionet teorike me të cilat bashkësia jashtëmartesore është caktuar si nocion ku bashkësia faktike në jetë e gruas dhe burrit që lind me vullnetin e lirë të partnerëve jashtëmartesorë pa intervenim të shoqërisë dhe po ashtu dhe ndërpritet.

---

<sup>60</sup>Përqindja e kurorave dhe fëmijëve jashtëmartesorë sipas Statistikave, Zagreb, 2005

### **3. Bashkësia jashtëmartesore mes gruas dhe burrit në Ligjin për familje**

Nga viti 1990 në sistemin juridik kroat ekziston dispozita kushtetuese e cila kërkon që raportet juridike në bashkësinë jashtëmartesore të rregullohen me ligj, pasi që kjo është themeli juridik

kushtetues për rregullimin e efektit të bashkësisë jashtëmartesore, jo vetëm në të drejtën familjare por edhe në të drejtat e sferave tjera. Megjithatë, në Kushtetutën e Republikës së Kroacisë nuk është treguar që fjala është për bashkësinë jetësore mes gruas dhe burrit as që në atë nuk ka udhëzim për përmbajtjen e rregullores në kuptim të krahasimit të kurorës dhe bashkësisë jashtëmartesore<sup>61</sup>.

Bashkësinë jashtëmartesore mes gruas dhe burrit e rregullojnë në Ligjin për familje dispozita që për supozimet që janë relevante për efektet juridike për bashkësinë e tij (neni 3), në të drejtën e mbështetjes të personit jashtëmartesor (neni 222-225) dhe në raportet pronësore të personit jashtëmartesor (neni 258)<sup>62</sup>.

Me dispozitën hyrëse në Ligjin për familje që në literaturë i quajtur definicion indirekt në bashkësinë jashtëmartesore, është rregulluar:

*“Dispozitat e këtij Ligji për efektet e bashkësisë jashtëmartesore zbatohen në bashkësinë jetësore të gruas së pamartuar dhe burrit të pamartuar, e cila zgjat së paku tri vite ose më pak nëse në atë ka lindur fëmija jashtëmartesor”*(neni 3).

Supozimet për të fituar të drejtën e efektit të familjes jashtëmartesore kanë të bëjnë me statusin mes gruas dhe burrit, si dhe për kohëzgjatjen e bashkësisë ose rrethanave që në bashkësi ka lindur fëmija jashtëmartesor. Efektet e bashkësisë kanë mbetur të kufizuara për partnerët jashtëmartesor në të drejtën e mbështetjes dhe rregullimit të raporteve pronësore (si dhe ndaj rregulloreve të vitit 1978 dhe 1998).

Rrethana që personat nuk janë në kurorë është relevante për lidhjen e kurorës së vlefshme, derisa pengesat tjera në kurorë nuk janë të rregulluara si fakte të përkufizimeve për të fituar të drejtat në bashkësitë jashtëmartesore sipas Ligjit për familje si p.sh. e drejta e trashëgimisë.

---

<sup>61</sup>Raportet juridike sipas sistemit juridik kroat, 1990.  
familje dhe efektet juridike sipas nenit 222-225

<sup>62</sup>Ligji për

Kuptimi i dispozitës është për statusin e bashkëshortëve në theksin që në të njëjtën kohë nuk mund që realisht të mirëmbahen dy bashkësi jetësore, derisa nëse kurora zgjat vetëm formalisht, mundësia e shkurorëzimit është në dispozicion. Nuk është relevante që njëri nga bashkëshortët të

dijë statusin bashkëshortit të tij të zgjedhur ose dikush e ekspozon rrezikun që në atë pikëpamje të jetë në huti (ose i gënjer).

Kohëzgjatja e bashkësisë jashtëmartesore prej së paku tri vite është qenësore për tërë efektin pronësor juridik sipas Ligjit për familje. Rregull është parimi i skadimit të vlefshmërisë dhe përgjegjësisë për raportet afatgjate jetësore, derisa lindja e fëmijës dhe para caktimit të afatit më saktë detyrohen ndaj familjes së formuar dhe anëtarëve të saj.

Me lindjen e fëmijës në bashkësi jashtëmartesore tërësisht ekziston familja, kurse në Republikën e Kroacisë çdo familje është nën mbrojtjen e vetë shtetit (neni 61.par.1 të Kushtetutës)<sup>63</sup>.

Në Konventën për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në familjen jashtëmartesore ka të bëjë me dispozitat e respektimit të jetës familjare (neni 8, Burime juridike të së drejtës familjare)<sup>64</sup>.

Kur bashkëshortët bëhen prindër ndaj tyre zbatohen dispozitat për rregullimin e raportit prindër fëmijë, d.m.th. rregulla për origjinën e fëmijës nga i ati dhe e ëma si dhe kujdesin familjar për fëmijën e përbashkët. Bashkëshortët, familja e të cilëve nuk i përmbush supozimet e përcaktuara nuk mund të fitojnë të drejtat familjare, d.m.th. efektet e përcaktuara nga Ligji për familje, eventualisht mund të kërkojnë zbatimin e së drejtës civile pronësore juridike.

Të drejtën e bashkëshortit jashtëmartesor për mbështetje e rregullon Ligji për familje me supozimet nga neni 3 dhe nga rrethanat (personale dhe pronësore) që Ligji për familje cakton për mbështetje të bashkëshortit (neni 222 në lidhje me nenin 217). Kërkesa për mirëmbajtje nuk mund të vendoset për kohëzgjatjen e bashkësisë, por vetëm pas ndërprerjes së saj edhe atë në afat prej gjashtë muaj nga shkurorëzimi i bashkësisë jetësore.

---

<sup>63</sup>Neni 61 par. 1 i Kushtetutës së R.Kroacisë

<sup>64</sup>Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në familjen bashkëshortore, neni 8.

Të drejtat tjera ndaj të cilëve gjykata është e autorizuar ta refuzojë kërkesën për mirëmbajtje, të vendosë për detyrimet e mirëmbajtjes zgjat deri në një vit dhe ata supozime për ndërprerjen e së drejtës për mirëmbajtje janë norma të njëjta si për mirëmbajtjen e bashkëshortit.

Raportet pronësore të partnerëve jashtëmartesorë nuk janë afërsisht të normuara por janë të rregulluara me rregulla parimore që për ata raporte janë paraparë zbatimi i dispozitave për raportet pronësore të bashkëshortëve. Neni 258 parasheh :

*“Bashkësia jashtëmartesore mes gruas dhe burrit që i përmbush supozimet nga neni 3 i këtij Ligji për efektet e së drejtës pronësore në të cilat në mënyrë të përgjegjshme zbatohen dispozitat nga Ligji për raportet pronësore mes bashkëshortëve.”*

E drejta e bashkëshortëve jashtëmartesorë është që me regjim ligjor (neni 248-254 nga Ligji për familje) të ndryshojnë me marrëveshje për caktimin e raporteve pronësore juridike në pronën që ekziston ose të ardhmes.

Në të drejtën kroate ka hy Ligji i ri për trashëgimi i a.q. efekt juridik i trashëgimisë së bashkësisë jashtëmartesore mes gruas dhe burrit. Bashkëshorti/ja ka të drejtë ligjore të trashëgimisë nga rendi i parë i trashëgimisë që i takon bashkëshortit/es (neni 8 Ligji për familje 2003). Megjithatë, për atë rast efekti janë përcaktuar kërkesa rigoroze në të cilat supozime për praninë të drejtës prindërore, kërkohet, që përveç statusit të gruas së pamartuar dhe burrit të pamartuar, bashkësia jashtëmartesore që ka zgjatur më shumë (që nuk është në pajtim me nenin 3 nga Ligji për familje) dhe është ndërpre me vdekjen e trashëgimlënësit, ashtu që janë plotësuar *supozimet që janë kërkuar për vlefshmërinë e kurorës.*

Për atë kërkesë shtesë bashkësia jashtëmartesore nuk ka efekt të së drejtës pronësore p.sh. bashkëshorti jashtëmartesor i mitur, person i privuar nga aftësia e veprimit ose pa aftësi për të gjykuar ose i afërm në nivelin e palejuar të afërsisë (për kurorë) ka themeluar bashkësi jashtëmartesore.

Sipas dispozitave që me rregullim juridik bashkësia jashtëmartesore në Ligji për familje, ajo është bashkësi jetësore mes gruas dhe burrit që ka efekte të kufizuara të së drejtës prindërore të përmbajtjes pronësore nëse atë bashkësi jashtëmartesore e kanë realizuar persona që nuk janë në kurorë dhe që zgjasin së paku tri vite ose më pak nëse në atë ka lindur fëmija i përbashkët.

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991, përfshihen dispozita juridike të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e familjes dhe martesës. Në nenin 40 të Kushtetutës është përfshirë dispozita juridike e cila parasheh :”*Republika i siguron kujdes dhe mbrojtje të veçantë*

*familjes*”<sup>65</sup>, që d.m.th se shteti ndërmer detyrime për mbrojtjen e familjes dhe antarëve të saj”. Përveç nenit 40 të Kushtetutës, dispozita mbi mbrojtjen e familjes dhe antarëve të saj përfshihen edhe në nenin 41, 42, ku është precizuar mbrojtja e veçantë e amësisë, fëmijëve dhe personave të mitur, pastaj të drejtat dhe detyrimet e prindërve të kujdesen për mirëmbajtjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, si dhe detyrimi i fëmijëve të kujdesen për prindërit e tyre të moshuar.

Përveç në Kushtetutë, problematika rreth mbrojtjes shoqërore të familjes është e rregulluar edhe me Ligjin për Familje. Kështu, në nenin 4 dhe 5 të Ligjit, përfshihen dispozita të cilat garantojnë mbrojtjen e familjes nga ana e shtetit. Në kontekst të kësaj mund të potencohet se dispozitat e përfshira në Deklaratën Universale tërësisht janë implementuar dhe janë pranuar në të drejtën nacionale të Republikës së Maqedonisë, përkatësisht në Kushtetutën dhe Ligjin për Familje. Implementimi dhe pranimi i këtyre dispozitave në legjislacionin nacional qartësojnë funksionin mbrojtës të familjes dhe antarëve të saj dhe se funksioni i familjes ka bazë juridike në Ligjin për familje, që gjithashtu në planin ndërkombëtar bazohet në dispozitat e Deklaratës të përmendur. Në këtë kontekst Deklarata udhëzon që edhe shteti është i detyruar për kujdes dhe mbrojtjen e familjes. Ekzistojnë institucione shtetërore adekuate duke filluar nga shëndetësia (në rast të sëmundjeve), deri tek institucionet e ndryshme për strehim (ato për fëmijët pa përkujdesje prindërore, deri tek ata për personat e moshuar dhe të dobët). Në kuadër të kësaj mbrojtje, rëndësi dhe rol të veçantë i njihet mbrojtjes sociale të organizuar e cila realizohet në tërë spektrin e veprimtarive shoqërore. Ky organizim mundëson krijimin e e regullativës ligjore të veçantë në sferën e sigurimit shëndetsor dhe mbrojtjes sociale, përgjatë sigurimit pensional deri tek formimi i organeve të veçanta dhe të përgjithshme shtetërore të cilat luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e familjes. Në Republikën e Maqedonisë organ i tillë është Qendra për Punë Sociale.

---

<sup>65</sup>Neni 40 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991, për mbrojtjen e familjes

Në nenin 5 të Konventës përfshihen dispozita të cilat kanë të bëjnë me marrdhëniet familjare, kështu që në paragrafi 2 të të njejtit nen thuhet :”*Edukimi familjar të përfshin edhe kuptimin e drejtë të amësisë si funksion shoqëror dhe njohjen e përgjegjësisë të përbashkët të burrit dhe*

gruas në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, duke kuptuar se në të gjithë rastet duhet parasëgjithash të mbahet llogari për interesat e fëmijës”. Nga dispozita e cituar e Konventës buron se burri dhe gruaja në të njejtën mënyrë të jenë përgjegjës dhe janë të detyruar ti plotësojnë nevojat e fëmijës, si psh: lidhur me mënyrën e jetetesës së tij, shëndetin e tij, edukimin, arsimimin etj.

Republika e Maqedonisë si nënshkruese e Konventës, ka implementuar dispozitat e saj në Kushtetutën dhe Ligjin e Familjes. Në nenin 40 të Kushtetutës alinea 3, është paraparë që prindët kanë të drejta dhe detyrime të kujdesen për fëmijët e tyre, për mbajtjen dhe edukimin e tyre, ndërsa në nenin 46 të Ligjit për familje në pjesën ku rregullohen të drejtat dhe detyrimet prindërore<sup>66</sup>, të cilat ata i kanë lidhur me fëmijën e tyre të mitur është paraparë që ” prindërit kanë të drejta dhe detyrime të mbajnë fëmijët e tyre të mitur,, të kujdesen për jetën dhe shëndetin e tyre, ti përgadisin ata për jetë dhe punë të pavarur, të kujdesen për edukimin e tyre, arsimimin dhe trajnim profesional të tyre”. Po në të njejtin nen, në paragrafin 2 janë të përfshira të drejtat e fëmijës, pra të gjithë ata të drejta që i gëzon fëmija, të cilat nga ana tjetër janë detyrime për prindërit. Kështu që, fëmija ka të drejtë të jetë i mbajtur, të jetë i përkujdesur, të mbrohet shëndeti i tij dhe jeta e tij, të jetë aftësuar për jetë dhe punë të pavarur, ti sigurohen kushte minimale për edukimin e tij, arsimimin, trajnimin profesional varësisht nga kushtet familjare.

Në nenin 16 Konventa në mënyrë të detajuar rregullon marrëdhëniet midis bashkëshortëve dhe të drejtat dhe detyrimet në martesë dhe familje, si dhe masat të cilat shtetet duhet ti ndërmarrin për eliminimin e diskriminimit midis burrit dhe gruas në martesë dhe familje si dhe barazia e tyre brenda familjes. Paragrafi 1, në pikat a dhe b të nenit 16, rregullon çështjen e barazisë midis bashkëshortëve. Mëtej, pika c, e të njejtit nen parasheh të drejta dhe përgjegjësi të njejta për bashkëshortët në momentin e lidhjes të martesës dhe divorcit, të cilat dispozita janë të implementuara edhe në Ligjin për familje të vendit tonë.

---

<sup>66</sup>Neni 46 nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë për të drejtat dhe detyrimet e prindërve

Në pikat ç, d, dh, e, të të njejtit nen parashihet parimi i barazisë lidhur me të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve, apo të drejta të njejtat prindërore, të drejta të njejtat që lirshëm dhe në mënyrë të përgjegjshme të vendosin për planifikimin e familjes, lidhur me kujdestarinë e fëmijës,

administrimin e pasurisë, të drejta të barabarta personale të burrit dhe gruas lidhur me të drejtën për zgjedhje të emrit personal, profesionit, të drejtat e pronësisë, fitimin, administrimin, gëzimin, huazimin e pronësisë etj.

Duke pasur parasysh se Republika e Maqedonisë është nënshkruese e Konventës, mund të konkludohet se detyrimet të cilat burojnë nga Konventa janë të implementuara në legjislacionin familjar apo në tërësi janë përmbushur, apo ndryshe thënë se legjislacioni ynë veçanërisht në sferën e të drejtës familjare, është rregulluar sipas këtij dokumenti ndërkombëtar<sup>67</sup>.

---

<sup>67</sup>Me Statusin e Prillit të vitit 1999, 163 shtete e ratifikuan Konventën në fjalë. Republika e Maqedonisë është shtet kontraktues i Konventës.

#### **4. Konventa për të drejtat e fëmijës**

Kjo Konventë u miratua në vitin 1989 dhe hyri në fuqi në vitin 1990. Konsiderohet njëri nga dokumentet ndërkombëtare më të pranuar në sferën e mbrojtjes juridike ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Konventa, përveç korpusit të të drejtave të njeriut të cilat i takojnë secilit, parasheh edhe të drejta tjera specifike si: të drejta të ndërlidhura me birësimin (neni 20-21), të drejta mbi mbrojtjen nga eksploatimi seksual dhe forma tjera të eksploatimit (neni 32 dhe 36), pranimin e statusit special të fëmijës në procedurat juridike (neni 40). Shtetet janë të detyruar të ndërmarrin të gjithë masat juridike dhe vendimet alternative me të cilat do ti mundësohen të gjithë të drejtat fëmijës dhe të njejtat ai ti gëzojë.

Parimet e kësaj Konvente janë veçanërisht të shprehura në nenin 40 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë të cilat kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet e prindërve.

Në këtë kontekst vlen të potencohet që, mbrojtja e të drejtave të fëmijës në Republikën e Maqedonisë është paraparë në disa vendime zakonore, apo dispozita për mbrojtjen e fëmijës të cilat përfshihen në Ligjin për familje dhe në shumë ligje tjera si psh: Ligji për mbrojtjen e fëmijëve<sup>68</sup>, Ligji për mbrojtje shëndetsore<sup>69</sup>, Ligji për mbrojtje sociale<sup>70</sup>, etj.

Përveç Konventës, në kuadër të mbrojtjes juridike ndërkombëtare të fëmijës, janë sjellë edhe dy Protokole fakultative: Protokoli fakultativ për kycje të fëmijëve në konflikte luftarake dhe Protokoli fakultativ lidhur me trafikimin me fëmijë, prostitucioni me fëmijë dhe pornografia me fëmijë<sup>71</sup>. Që të dy Protokolet plotësojnë mbrojtjen juridike të fëmijës të paraparë në Konventë. Protokolet parashikojnë edhe numër të konsiderueshëm të detyrimeve të shteteve për ndërmarrjen e një numri të masave ligjore dhe administrative për mbrojtjen e fëmijëve nga trajnimet e detyrueshme në formacionet ushtarake dhe pjesmarrje në konflikte luftarake, si dhe për mbrojtje dhe luftimin kundër tregtimit me fëmijë, prostitucionit dhe pornografisë me fëmijë.

---

<sup>68</sup>Ligji për mbrojtjen e fëmijëve i RM-së, Gazeta zyrtare nr.23/13

<sup>69</sup>Ligji për mbrojtjen shëndetsore i RM-së, Gazeta zyrtare nr. 43/12

<sup>70</sup>Ligji për mbrojtjen sociale i RM-së, Gazeta zyrtare , nr.79/09

<sup>71</sup>Konventa për mbrojtje juridike ndërkombëtare të fëmijëve

## **5. Aktet regjionale të cilat rregullojnë marrëdhëniet në familje**



Përveç instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat u elaboruan paraprakisht në këtë studim, egzistojnë edhe një numër i konsiderueshëm i instrumentave juridike lidhur me këtë problematikë, siç janë : Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, Konventa sociale evropiane, Konventa Afrikane për të drejtat e njeriut dhe popujve, Konventa Afrikane për të Drejtat e njeriut etj. Edhe në këta akte regjionale mbi të drejtat e njeriut janë përfshi dispozita me të cilat mbrohen, respektohen të drejta të caktuara të lidhura me familjen.

## **6. Konventa Evropiane mbi statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesë**

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës, nënshkruese të saj, duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është arritja e një uniteti sa më të madh ndërmjet anëtarëve të tij, në veçanti me miratimin e rregullave të përbashkëta në fushën e ligjit; duke vënë re se në një numër të madh të shteteve anëtare janë bërë ose po bëhen përpjekje për të përmirësuar statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martesë, duke zvogëluar dallimet ndërmjet statusit të tyre ligjor dhe atij të fëmijëve të lindur në martesë të cilat janë në disavantazh juridik ose social të të parëve; duke njohur se ende ekzistojnë mospërputhje të mëdha në ligjet e shteteve anëtare në këtë fushë; duke besuar se situata e fëmijëve të lindur jashtë martesë duhet të përmirësohet dhe se hartimi i disa rregullave të përbashkëta në lidhje me statusin e tyre ligjor do të ndihmojë këtë objektiv dhe në të njëjtën kohë do të kontribuojë për një harmonizim të ligjeve të shteteve anëtare në këtë fushëmegjithatë, duke pasur parasysh se është e nevojshme të pranohen etapa progresive për ato shtete të cilat nuk e konsiderojnë veten në gjendje të miratojnë menjëherë disa rregulla të kësaj konvente që kanë rënë dakord dhe që përbëhet nga 16 nene. Vendimi i Gjykatës lidhur me vendosje për mbajtje mund të ndryshohet kur ndryshojnë rrethanat që kanë sjell vendimin gjykatës për mbajtje.

Zgjidhjet ligjore ekzistuese të legjisllacionit të familjes maqedonase në pikëpamje të mbështetjes së fëmijëve pas divorcit hasin në probleme të caktuara në praktikë, dhe në dëm të fëmijëve që janë në një numër të madh rastesh nuk marrin mbështetje nga prindi me të cilët ata nuk jetojnë së bashku.

Duke dështuar për të përmbushur mbështetjen e fëmijëve ata janë rrezikon edukimin e duhur, edukimin dhe edukimin, dhe barra e kapërcimit të problemeve të përditshme bie vetëm me prindin të cilën fëmija jeton. Në vitin 2013, në Republikën e Maqedonisë janë divorcuar 2045 martesas.

Sipas të dhënave të Gjykatës Themelore Shkup 2 Shkup në vitin 2013, janë pranuar lëndë nga sfera e familjes me shenjën P2. 1333 lëndë. Në vitin 2013 janë përfunduar 1327 lëndë. Shumica janë divorce edhe atë 1071, alimentacion të fëmijëve 157 lëndë, ndryshime të vendimit për ndarjen e fëmijëve 38 lëndë, kontestim të atësisë dhe amësisë 32 lëndë, dhunë familjare 19 lëndë, verifikim të atësisë dhe mëmësisë 11 lëndë, ndryshim vendimi për ndarje të fëmijës 38 nga dy lëndë mbajtje të bashkëshortit dhe anulim të martesës dhe nga një lëndë verifikim të ekzistimit të bashkësisë jashtëmartesore, të martesës dhe marrëdhëniet tjera të familjes, si dhe anulimin e deklaratën për njohjen e atësisë.

Duke vepruar kështu, këta fëmijë janë të në pozitë të pa favorizuar nga fëmijët e tjerë. Ajo që është në kundërshtim me Kushtetutën dhe të drejtat e garantuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës. Legjislacioni ynë ende nuk praktikon modelet dhe zgjidhjet e miratuara në ligjin bashkëkohor evropian të familjes në lidhje me ofrimin e mbështetjes për fëmijët të cilëve u mohohet. Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë shfuqizoi nenin 67 paragrafi 2 dhe nenin 70 paragrafi 2 të Ligjit për Familjen<sup>72</sup>, me të cilin parashihej padia për mohimin e atësisë ose të amësisë fëmija të mund ta dorëzojë atë më së voni deri në moshën 21 vjeçare.

---

<sup>72</sup>Gjykata Kushtetuese në Republikën e Maqedonisë shiqp nenin 67 dhe 70, paragrafi 2 nga Ligji për familje

Sipas Gjykatës, me dispozitat ligjore të shfuqizuara shkilen parimet e deklaruara nga disa aspekte. Pikërisht, marrëdhënia familjare juridike si një çështje e së drejtës familjare paraqet kategori të veçantë në të cilën dominim kanë çështje personale ligjore, të cilat u delraohen të drejtave dhe detyrimeve ndërmjet anëtarëve të familjes, paraprakisht me karakter jo pronësor (besnikëri, mbështetje, respekt, etj) dhe të drejtat e detyrimit me karakter pronësor (e drejta për mirëmbajtjen në mes bashkëshortëve dhe në mes të prindërve dhe fëmijëve), ku afatet e parapara në Ligj paraqejn pengesë kufi për fillimin ose ndërprerjen realizimit të drejtave, megjithatë ata nuk duhet të paraqesin pengesë për realizimin e disa të drejtave.

Kjo për faktin se me kufizimin e së drejtës, fëmija mund të ngrejë padi në cilën do periudhë të mund të paraqesë padi për mohimin e atësinë/amësinë pikërisht duke përcaktuar një kufi të caktuar të moshës, sipas Gjykatës, e drejta e fëmijës është e kufizuar nga momenti i njohjes me prindërit biologjikë të vërtetë të mund ta realizojë këtë të drejtë duke parashtruar padi, në kundërshtim me nenin 25 të Kushtetutës, nenin 8 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Nenet 3 dhe 7 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës. Neni 67 i Ligjit për Familjen, i shfuqizuar thotë : „ Fëmija mund të kundërshtojë që babai i tij është një person i cili sipas këtij ligji konsiderohet baba i tij. Fëmija mund të parashtrtojë një padi për mohimin e atësisë më së voni në moshën 21 vjeçare.

“Në rastet kur bashkëshorti i nënës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 64 paragrafi 2 të këtij ligji, nuk ka parashtruar padi për mohim të atësisë, kurse e ka deklaruar në atë afat pranë Qendrës për Punë Sociale se nuk konsiderohet baba i fëmijës dhe kur nëna pëlqimin për adoptim të fëmijës në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në nenin 106 të këtij ligji në afat prej tre muaj pas mbarimit të afatit në nenin 64 paragrafi 2 të këtij ligji, e parashtron kujdestari i fëmijës me miratimin e qendrës për punë sociale.”

Neni 70 i shfuqizuar, sërish nga Ligjit për Familjen, thotë : „ Një fëmijë mund të kontestojë amësinë e një gruaje e cila në çertifikatën e lindjes është regjistruar si nëna e tij. Fëmija për shkak të kontestimit të mëmësisë mund të parashtrtojë padi deri në moshën 21 vjeçare”.

Për Gjykatën Kushtetuese problematike nga pikëpamja kushtetuese është arsyeja përse të ketë limit deri në moshën 21 vjeçe për fëmijën që ta kontestojë atësinë, domethënë amësinë me padi, për të cilën arsye është ngritur procedura.

## 7. Shembuj nga praktika gjyqësore

Praktika gjyqësore në kontestet familjare është e pasur dhe kjo është vetëm një pjesë e së njëjtës (është rreth vendimeve gjyqësore të formës së prerë) që mund t'u shërbejnë të interesuarve në lidhje me zbatimin e ligjeve në këtë sferë.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gostivar P2 – 155/18 pjesërisht është miratuar padia e paditësit në pjesën e alimentacionit mujor për një kërkesë më të madhe. Vendimi ndryshohet në mënyrë që i padituri është i detyruar të paguajë për dallim nga shuma e gjykuar në vend të 5.000 denarëve deri në shumën e kërkuar prej 9.000 denarë. Kërkesa më e madhe llogaritur nga 13.09.2018 si ditë e parashtrimit të padisë derisa ekzistojnë kushtet ligjore për atë, refuzohet si e pabazë.

Kërkesë padia e të miturit paditësit S.A. përmes përfaqësuesit të tij ligjor së ëmës A.E. me të cilën kërkon të detyrohet i padituri t'i paguajë të miturit paditës përmes përfaqësuesit të tij ligjor gjithësej shumë prej 144.000 denarë në emër të alimentacionit për gjithësej katërmëdhjetë muaj pikërisht për çdo muaj nga 9.000 denarë llogaritur nga muaji maj 2017 përfundimisht me muajin gusht 2018 në afat prej 8 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, refuzohet si e pabazë.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gostivar P2 – 146/17 pjesërisht vërtetohet kërkesë padia e paditësit dhe vërtetohet që i padituri është i ati i paditëses T.S. nga Gostivari, nga e ëma E.S. ashtu që i padituri detyrohet që të bëjë regjistrimin e atësisë në Librat amë të të lindurve që udhëhiqet për qytetin e Gostivarit, pra në shërbimin e gjendjes civile.

Kërkesë padia e të miturës paditëses T.S. përmes përfaqësuesit të saj ligjor së ëmës E.S. me të cilën kërkon i padituri të bëjë regjistrim të atësisë në Librin amë të të lindurve, pra shërbimi i gjendjes civile dhe e detyroi të paditurin me shpenzime në kontest dhe pasi që gjykata e mbajti procedurën në mungesë të tij, në përputhje me nenin 280 paragraf 2 nga LPK-ja për qytetin e Gostivarit në afat prej 8 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, refuzohet si e pabazë.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga provat e nxjerra në procedurë dhe deklarata e dëshmitarëve prej ku vërtetoi që mes paditëses dhe të paditurit kanë qenë në lidhje dhe se një periudhë kanë jetuar bashkë.

Në përputhje me dispozitën nga neni 61 nga Ligji për familje-teksti i përmirësuar, për prind të fëmijës, lindur jashtë kurorës do të llogaritet personi që me të ëmën e fëmijës ka pasur marrëdhënie pikërisht në periudhën prej së paku 180 deri 300 ditë para lindjes së fëmijës, derisa nuk dëshmohet e kundërta.

Gjatë verifikimit të atësisë gjykata kishte parasysh sidomos dhe jetën e përbashkët dhe marrëdhëniet reciproke të ëmës me fëmijën dhe të paditurit para dhe pas lindjes së fëmijës në përputhje me paragrafin e këtij neni.

Në përputhje me Ligjin për Familjen, gjykata mund të përcaktojë shumën e kujdesit në një sasi ose përqindje të caktuar.

Ky formulim ligjor me përdorimin e fjalës "ose" do të thotë se nuk ka asnjë mundësi ligjore për të kombinuar mënyrën e vendosjes së alimentacionit për shkak të rrethanave të mësipërme në të cilat mund të bien dhënësit e mbajtjes, do të ishte më e përshtatshme në drejtim të përcaktimit të përqindjes për kujdes nga paga për të përcaktuar dhe shumën e caktuar në të holla që do të jetë shuma minimale në rast se ju nuk mund të paguani një përqindje të procedurës përmbartimore. Një qëndrim i tillë rrjedh nga njohuritë në praktikën e kaluar, si në përcaktimin dhe në kryerjen e mbajtjes së ofruar.

Prindi që tërësisht vetë e ka mbajtur fëmijën e tij të mitur ka të drejtë të kërkojë nga prindi tjetër t'ia kompensojë një pjesë të shpenzimeve në proporcion me mundësitë e tij në kohën në të cilën ai është kujdesur.

Vendimet ekzistuese ligjore në Legjislacionin e familjes maqedonase në pikëpamje me sigurimin e kujdesit të fëmijëve pas divorcit hasen disa probleme të caktuara në praktikë, kurse në dëm të fëmijëve të cilët në shumë raste nuk e gëzojnë kujdesin ekzistencial nga prindi që nuk jetojnë bashkë.

Me mospërbushjen e kujdesit të fëmijëve rrezikohet kujdesi i drejtë ndaj tyre, edukimi dhe arsimimi, kurse barra e tejkalimit të problemeve të përditshme bie vetëm mbi prindin me të cilin jeton fëmija. Në vitin 2013, në Republikën e Maqedonisë u divorcuan 2045 martesat.

Sipas të dhënave të Gjykatës Themelore Shkup 2 në vitin 2013 janë pranuar lëndë nga sfera e familjes me shenjën P2 edhe atë 1333 lëndë.

Në vitin vijues 2013, 1327 lëndë janë përfunduar. Pjesa më e madhe janë divorce edhe atë 1071, kujdes ndaj fëmijëve 157 lëndë, ndryshime vendimesh për dhënien e fëmijëve 38 lëndë, konteste të atësisë dhe amësisë 32 lëndë, dhunën në familje 19 lëndë, verifikim të atësisë dhe amësisë 11 lëndë, ndryshimin e vendimit për dhënien e fëmijëve 38 lëndë, nga dy lëndë verifikim të ekzistimit të bashkësisë jashtëmartesore, martesë dhe lloje tjera të marrëdhënieve familjare, anulim të deklaratës për pranim të atësisë.

Në të njëjtin vit me shenjë P3, pasuria e fituar gjatë martesës janë pranuar gjithsej 64 lëndë, me të njëjtën bazë janë zgjidhur 69 lëndë.

Në vitin 2014 në regjistrin e kontesteve familjare janë pranuar 1368 lëndë, kurse janë zgjidhur 1273 prej të cilave 1128 lëndë divorce, kujdes ndaj fëmijëve 139 lëndë, kontestim të atësisë dhe amësisë 12 lëndë, verifikim të atësisë dhe amësisë 32 lëndë, dhunë familjare 30 lëndë, konteste tjera familjare 6, nga dy lëndë për përcaktimin e ekzistimit të bashkësisë jashtëmartesore dhe kërkesës për caktimin e përkohshëm të fëmijëve, si dhe në një lëndë për anulimi të deklaratës së njohjes së atësisë, anulim të kurorës, vazhdimi i adoptimit dhe mbajtje të bashkëshortit.

## **8. Regjistrimi i bashkësisë jashtëmartesore te noteri**

Bashkësia jashtëmartesore do të regjistrohet te noteri publik. Kjo është pjesë e reformës së Ligjit për familjen në Kodin civil të ardhshëm që Qeveria tashmë po e përgatit përmes Ministrisë së Drejtësisë.

Personat që jetojnë bashkë, por nuk duan të kurorëzohen dhe regjistrohen para një ofiqari, do mund të bëjnë një deklaratë tek një noter publik dhe të marrin certifikatë se jetojnë në bashkësi jashtëmartesore.

Procedura duhet t'i lehtësojë gjykatat dhe njëkohësisht të shkurtohen procedurat dhe koha për divorc. Ajo do të jetë një dokument zyrtar me të cilin do të dëshmohet kur ka filluar bashkësia jashtëmartesore dhe verifikimi i firmës te noterit do të kushtojë 100 denarë plus 50 denarë taksa gjyqësore.

Në Maqedoni ka gjithnjë e më shumë bashkësi jashtëmartesore. Statusi i bashkësisë jashtëmartesore është i barabartë me statusin e kurorës.

Kjo do të thotë që pas një viti jetë të përbashkët, partnerët kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime sikur të jenë në kurorë. Ata kanë të drejtën e ndarjes së pasurisë, të trashëgojnë pension nëse ndonjëri vdes, kanë të drejtën të kërkojnë alimentacion. Ideja që gjykatat t'i lejojnë divorcet me marrëveshje noterëve publik është në pritje.

Duke ndjekur shembullin e vendeve evropiane, Qeveria filloi një procedurë disa vite më parë për të lehtësuar procedurën e divorcit kur bëhet fjalë për kurorën kur nuk ka fëmijë të mitur.

Divorci para noterit duhet të aplikohet vetëm në rastet kur të dy partnerët bien dakord për divorc dhe nuk kanë mosmarrëveshje. Dhoma e Noterëve të Republikës së Maqedonisë thotë se ata janë të gatshëm ta marrin përsipër këtë punë nga gjykatat.

Por, Qeveria e ka shtyrë këtë reformë dhe nuk ka përgjigje të saktë kur ndryshimet e propozuara legislative do të vihen në debat publik.

Tani divorci realizohet ekskluzivisht në gjykatë, me padi ose me kërkesë të ndërsjellë. Gjykata thërret partnerët në seancë dëgjimore dhe zhvillon një procedurë pajtimi.

Nëse ka fëmijë, kërkohet një mendim nga Qendra për Punë Sociale. Divorci mund të zgjasë dy javë, por edhe tre ose më shumë muaj nëse partnerët nuk mund të bien dakord.

Numri i shkurorezimeve në vitin 2015 shënon rënie prej 0,5% krahasuar me vitin 2014, duke arritur në 2,200 divorce.

Sidoqoftë, martesat e divorcuara në tre muajt e parë të këtij viti shënuan rritje prej 20,5% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2015 dhe numri i tyre është 664. Martesa më pak, 74 ose 3,4% gjatë vitit u divorcuan në gusht dhe më tepër 205 ose 10,5%, në dhjetor.

Sipas kohëzgjatjes së martesës, shumica e divorceve, 498, kanë ndodhur midis 5 dhe 9 vite pas martesës.

Sipas të dhënave nga Zyra Shtetërore e Statistikave, numri i divorceve ka qenë në rritje të vazhdueshme vitet e fundit, kurse në rënie numri i kurorave të lidhura.

Shifrat tregojnë se në vitin 2014, krahasuar me vitin 2013, janë lidhur 1,2 përqind më pak martesa, ose 13.813 martesa. Në shumicën e rasteve, lidhja e kurorës së parë është 92,7 përqind te gratë dhe 90,6 përqind te burrat. Në një kurorë të dytë, me 8,7 përqind dhe në një kurorë të tretë me 0,7 përqind nga numri i përgjithshëm i kurorave të lidhura, më tepër ka të ngjarë te burrat.

---

<sup>73</sup><https://tera.mk/registratsija-na-vonbrachna-zaednitsa-kaj-notar/>



## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Nga hulumtimi i bërë institutit të bashkësisë jashtëmartesore mund të konkludojmë se bashkësia jashtëmartesore në analogji me martesën, është bashkësi e jetesës së vazhdueshme e një burri dhe një gruaje, por pa u rregulluar me ligj. Bashkëshortët jashtëmartesorë duhet të kenë jetuar në çift dhe të jenë me sekse të kundërta.

Mund të themi se bashkësia jashtëmartesore me tepër pëlqehet nga gjeneratat e reja para se të lidhin martesë. Bashkësia jashtëmartesore themelohet me shprehjen e vullnetit në mënyrë joformale të një burri dhe një gruaje për jetesë të përbashkët. Pra, element themelor i bashkësisë jashtëmartesore është jetesa e përbashkët, ngase pa jetë të përbashkët nuk mund të ketë as bashkësi jashtëmartesore. Qytetarët, në kushte të njëjta janë të barabartë në trashëgimi.

Për sa i përket trashëgimisë bashkëshortët jashtëmartesorë nuk trashëgojnë njëri tjetrin, ashtu sikundër ndodh në bashkësinë martesore.

Pasuria të cilën bashkëshortët jashtëmartesorë do ta fitojnë në bashkësinë jashtëmartesore llogaritet si pasuri e tyre e përbashkët, pra paraqet pronën e tyre të përbashkët. Ndërsa pasura të cilën njëri nga bashkëshortët e ka pasur përpara bashkësisë jashtëmartesore paraqet pasurinë e tij të veçantë, i cili në mënyrë të pavarur disponon dhe administron me të.

Historikisht, fëmijët jashtëmartesor kanë pasur pozitive diskriminuese në familje dhe gjithashtu në shoqëri. Mirëpo tani si rrethoj e ndikimit të së drejtës ndërkombëtare mbi të drejtën e brendshme të një vendi, pozita e fëmijëve jashtëmartesor është përmirësuar dukshëm.

Fëmijë jashtëmartesor quhet: çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e pamartuar, çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e ve pas kalimit të afatit prej 300 ditësh nga dita e zgjidhjes së martesës, çdo fëmijë që e ka lindur gruaja e martuar gjatë martesës nëse atësia e fëmijës është kundërshtuar gjyqësisht me aktgjykim të formës së prerë.

Në të drejtën tone fëmijët e lindur jashtë martese kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesë. Edhe për sa i përket trashëgimisë fëmijët jashtëmartesorë janë plotësisht të barabartë me fëmijët martesorë. Prindërit, organet kompetente dhe gjykatat në vendimet dhe veprimtaritë e tyre duhet ta kenë si konsideratë parësore interesin dhe kujdesin më

të lartë për fëmijët. Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë.

Sipas statistikave në mesin tonë fëmijët jashtëmartesor lindin si pasojë e shumë shkaqeve si p.sh. bashkëjetesa është shfaqur si një dukuri së fundmi në jetën e çifteve të reja, si rezultat i kësaj çiftet edhe lindin fëmijë të cilët nuk janë fryt i martesës të kurorëzuar në gjendjen civile.

Çdo i teti fëmijë në Maqedoni është jashtëmartesor, sipas raportit të fundit të Sistemit Evropian të Statistikave, që është tre herë e gjysmë më pak se mesatarja e Bashkimit Evropian. Sipas të dhënave të Eurostatit, rreth 12 përqind nga gjithsej numri i lindjeve në Maqedoni në vitin 2016 kanë lindur jashtë martesë, ndërsa në Bashkimin Evropian mesatarja është 43 përqind.

Shteti dhe shoqëria duhet t'u ofrojnë familjeve mbështetjen e nevojshme për të mbajtur në gjirin e tyre fëmijët, për të parandaluar keqtrajtimin dhe braktisjen e tyre, si dhe për të ruajtur qëndrueshmërinë e familjes. Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

## **BIBLIOGRAFIA**

1. Abdulla Aliu,

2. Aurela Anastasi, Çështje të njohjes së atësisë në kuadrin e të drejtës për një jetë familjare normale, Tiranë, 2004, revista “Ligji-mundësi zhvillimi për gratë”,
3. Asbjern Eide dhe Wenche Barth Eide, Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut, botuar në Holandë
4. Dr. Nerimana Traljic, Suzana Bubic, e dr
5. rD Marina Janjic-Komar dr Radoje Korac dr Zoran Ponjavic
6. Mira Alinc
7. Dr. Sc. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare
8. Faik Brestovci, E drejta e procedurës civile, ETMMKSAAK, Prishtinë, 2000
9. Лилјана СпиРОВИЧ - ТРПЕНОВСКА
10. Arta Mandro-Balili,
11. Prof. Asst. Dr. Jorida Xhafaj dhe Anton N. Prishtinë, Mars 2017, Të drejtat pronësore dhe trashëgimore të grave
12. Santhipi Begeja
13. Vojislav Bakic
14. Дејан МицКОВИЧ

## **Akte ligjore, Konventa**

1. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë 1991.
2. Konventa për mbrojtje juridike ndërkombëtare të fëmijëve. burimi
3. Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në familjen bashkëshortore, burimi
4. Konventa e OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” burimi,
5. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve i RM-së, Gazeta zyrtare nr.23/13
6. Ligji për mbrojtjen shëndetsore i RM-së, Gazeta zyrtare nr. 43/12
7. Ligji për mbrojtjen sociale i RM-së, Gazeta zyrtare , nr.79/09
8. Legjislacioni në Republikën e Kroacisë për bashkësitë jashtëmartesore
9. Deklarata universale mbi të drejtat e njeriut burimi
10. Kushtetutës së R.Kroacisë burimi
11. Ligji nr.8950, data 10.10.2002
12. Rekomandimet për çiftet e pamartuara sipas vlerësimit të KE-së, 1998. burimi
13. Zakon za sopstevenost i drugi stavrni prava ( Sl. Vesnik na RM, Br 18/2001
14. KOmentar zakon za semsejstvo.....

## **Burime nga internet**

1. <http://pravo.org.mk/>
2. [http:// wikipedia.org.mk/](http://wikipedia.org.mk/)
3. <http://pravdiko.mk>
4. [Family Law](#)
5. <https://tera.mk/registratsija-na-vonbrachna-zaednitsa-kaj-notar/>

